



ANALIZA VJETORE

2016



Përmbajtja

1. HYRJE	4
1.1. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA.....	4
2. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2016	7
2.1. Ndryshimet legislative	7
2.1.1. Prokurimi Publik.....	7
2.1.1.1. Iniciativat nënligjore të APP	7
2.1.1.2. Udhëzime dhe Vendime të APP	7
3. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2016	11
4. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE	13
4.1. Bashkëpunimi i APP me institucione homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së	13
4.2. Bashkëpunimi i APP me institucione të tjera në Shqipëri	14
5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË SEKTORIT JURIDIK PRANË DREJTORISË JURIDIKE DHE MONITORIMIT 16	
5.1. hartimi i akteve nënligjore dhe udhëzimeve	16
5.2. Praktikat e shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshilla apo udhëzimesh gjatë këtij viti.....	16
5.3. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	18
5.4. Përfaqësimi në proceset gjyqësore	20
6. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË MONITORIMIT PRANË DREJTORISË JURIDIKE DHE MONITORIMIT	24
6.1 Monitorimi i Procedurave të prokurimit nga APP	24
6.1.1. Gjetjet dhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të monitorimit	28
6.2. Shqyrtimi i raporteve audituese	31
7. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PUBLIKIMEVE.....	33
7.1. Sektori i Publikimeve	33
7.1.1. Njoftime për Procedura	33
7.1.2. Njoftime për Ankande Publike.....	34
7.1.3. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat.....	34
7.2. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, të shpallura gjatë vitit 2016.....	35

7.2.1.	Statistika për procedurat e prokurimit të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik....	35
7.2.1.1.	Statistika sipas Njoftimit të kontratës.....	35
7.2.1.2.	Statistika sipas llojit të procedurave	36
7.2.1.3.	Statistika për njoftimet e fituesit	37
7.2.1.4.	Statistika për kontratat e nënshkruara	38
7.2.1.5.	Statistika mbi përqindjen e kursyer	40
7.2.2.	Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.....	42
7.2.3.	Marrëveshjet Kuadër	48
7.2.4.	Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël	50
7.2.5.	Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP gjatë vitit 2016	52
7.2.6.	Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2016	53
7.3.	sektori i teknologjisë së informacionit	55
7.3.1.	Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP	59
7.3.2.	Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2016	59
7.3.3.	Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik.....	61
7.3.4.	Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik për procedurat e arkivuara ..	63
7.3.5.	Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik	64
7.3.5.1.	Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve	64
7.3.5.2.	Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas 24 orëve.	65
7.3.5.3.	Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas ditëve të javës.	67
7.3.5.4.	Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas muajve të vitit.	68
7.3.5.5.	Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas qyteteve kryesore.	69
7.3.5.6.	Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas shteteve.	70
7.3.5.7.	Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve dhe sistemeve operative.	71
8.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, INTEGRIMIT DHE FINANCËS.....	75
8.1.	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	75
8.2.	Autoriteti Përgjegjës	76
8.3.	Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore.....	77
8.3.1.	Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare	77

8.3.2.	Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore	78
8.4.	Integrimi european	78
8.5.	Gjendja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2016	80
9.	PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2016	82

1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (këtu e në vijim “APP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2016 deri në 31 Dhjetor 2016.

Gjatë vitit kalendarik 2016, APP e ka ushtruar veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar si dhe në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 143, datë 06.07.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

1.1. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA

Gjatë vitit 2016, APP është asistuar nga projekti i Bankës Botërore “Përmirësimi i monitorimit të përputhshmërisë dhe rritja e transparencës në prokurimin publik në Shqipëri”, i cili ka për qëllim të mbështesë Qeverinë Shqiptare për të përmirësuar dhe përforcuar më tej sistemin e monitorimit të përputhshmërisë me ligjin për prokurimin publik, për të përmirësuar mekanizmat e shqyrtimit të ankesave, si edhe të rrisë kapacitetet e KLSH për auditimin e kontratave të prokurimit publik në Shqipëri.

Në kuadër të këtij projekti, APP është asistuar me konsulencë për 5 aktivitete të ndryshme dhe konkretisht:

1. Përcaktimi i indikatorëve të performancës. Për këtë është kontraktuar një ekspert ndërkombëtar, i cili ka hartuar një manual të detajuar, i cili përfshin jo vetëm indikatorët, por edhe metodologjinë për mbledhjen dhe analizimin e tyre.

Dokumenti i mësipërm do të shërbejë si bazë për përzgjedhjen e indikatorëve më të përshtatshëm për sistemin e prokurimit në Shqipëri dhe përdorimin e tyre për monitorimin e këtij sistemi në mënyrë periodike.

2. Modifikimi i sistemit të prokurimit elektronik për të mundësuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Konsulenti lokal i kontraktuar për këtë qëllim, ka hartuar një raport të detajuar lidhur me problematikat e sistemit aktual në këtë drejtim dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për ndryshimet që duhet të bëhen me qëllim adresimin e tyre.

3. Përforcimi i monitorimit të përputhshmërisë me legjislacionin e prokurimit publik në Shqipëri. Në lidhje me këtë aktivitet është kontraktuar një konsulent lokal me qëllim analizimin e situatës aktuale në autoritetet kontraktore sa i takon kapaciteteve të punonjësve të përfshirë në procesin e prokurimit, si për zhvillimin e procedurave, ashtu edhe për monitorimin e zbatimit të kontratës në vijim të tyre.

Në vijim të këtij procesi, konsulenti ka përgatitur raportet përkatëse duke pasqyruar problematikat e identifikuara dhe duke dhënë rekomandimet përkatëse për adresimin e tyre.

4. Arkivimi elektronik i procedurave të prokurimit. Në kuadër të këtij aktiviteti dhe duke pasur parasysh zhvillimin elektronik të procedurave që prej vitit 2009, konsulenti lokal i kontraktuar analizoi mënyrën aktuale të funksionimit të arkivës elektronike, pjesë e sistemit të prokurimit elektronik, mënyrën e ruajtjes së të dhënave në këtë modul dhe kapacitetin e saj dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e saj dhe mënyrës së ruajtjes së të dhënave të hedhura në sistem në vitet e kaluara.
5. Hartimi i rregullave për hetimin e procedurave të prokurimit nga institucionet e jashtme. Ky aktivitet ka për qëllim identifikimin e shkallës së transparencës në procedurat e prokurimit dhe aksesit të institucioneve të ndryshme, organizatave jo-fitimprurëse apo organizmave të tjerë në këto procedura për qëllime hetimi apo studimi dhe përgatitjen e rregullave të posaçme për këtë qëllim.

Në këtë kuadër, konsulenti lokal i kontraktuar ka përgatitur raportin e tij me rekomandimet mbi rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe ka propozuar një draft udhëzim për t'u miratuar nga APP në këtë kontekst.

Banka Botërore ka vendosur të vazhdojë asistencën e APP nëpërmjet këtij projekti edhe gjatë vitit 2017 me aktivitete të reja që do të parashikohen në vijim.

Gjithashtu, sikurse dhe në vitet paraardhëse, edhe gjatë këtij viti, APP ka vazhduar të asistohet nga SIGMA (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qëndrore dhe Lindore) për përmbushjen e detyrimeve të saj në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Gjatë këtij viti, asistenca e SIGMA-s ka qenë e fokusuar kryesisht në dhënien e ekspertizës së nevojshme në lidhje me fillimin e punës për përafrimin e Direktivës së BE-së nr. 2009/81/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë, kontratave për furnizime dhe

kontratave të shërbimit nga autoritetet kontraktore apo entet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në këtë kuptim, SIGMA ka ndihmuar në përkthimin e direktivës në gjuhën shqipe me qëllim procedimin në kohë sa më të shpejtë nga grupi ndërinstitucional punës i ngritur për hartimin e projektligjit për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjithashtu, përfaqësuesit e këtij organizmi kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të ndihmuar në çdo fazë të procesit, duke dërguar edhe informacione të nevojshme lidhur me implementimin e kësaj direktive nga vendet anëtare dhe problematikat e hasura në këto vende.

Po kështu, SIGMA ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm edhe në përgatitjen e ndryshimeve në ligjin e prokurimit publik sa i takon riorganizimit të Komisionit të Prokurimit Publik, nga një institucion në varësi të Kryeministrit, në një institucion të pavarur, duke e sjellë kështu sistemin e ankimit për procedurat e prokurimit në të njëjtën linjë me parashikimet e Direktivës 89/665/KEE.

Procesi i përgatitjes së ndryshimeve të mësipërme ka filluar në fund të vitit 2016 dhe pritet të finalizohet me miratimin e projektligjit nga Parlamenti brenda muajit Prill 2017.

2. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2016

2.1. NDRYSHIMET LEGJISLATIVE

2.1.1. Prokurimi Publik

2.1.1.1. Iniciativat nënligjore të APP

Gjatë vitit 2016, Ministria e Financave bëri një sërë ndryshimesh në Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe, në zbatim të tyre, u miratua VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, e cila parashikonte se prokurimet publike nuk mund të zhvillohen përtej datës 15 tetor të çdo viti me përjashtim të disa rasteve të parashikuara në këtë vendim.

Duke pasur parasysh që ndryshimet e mësipërme ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktore, me qëllim përshtatjen e tyre me parashikimet nënligjore të prokurimit publik në fuqi, Sektori Juridik pranë APP punoi për hartimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të cilat u miratuan me VKM Nr.823, datë 23.11.2016.

Qëllimi i VKM Nr. 823, datë 23.11.2016 ishte përshtatja e nenit 76, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me parashikimet e nenit 51 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe me VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”.

2.1.1.2. Udhëzime dhe Vendime të APP

Gjatë vitit 2016, për t’u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, APP ka hartuar Udhëzimet si më poshtë:

- ❖ **Udhëzimi Nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e APP Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”**

Gjatë ushtrimit të detyrave të saj, APP ka konstatuar se problemet më të shumta që autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë kanë me procedurat e prokurimit, i referohen zhvillimit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.

Për këtë qëllim, për t'i ardhur në ndihmë si autoriteteve kontraktore, ashtu edhe operatorëve ekonomikë, Sektori Juridik punoi në drejtim të përmirësimit të Udhëzimit Nr. 3, datë 27.01.2015.

Ndryshimet në Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015, ndihmojnë autoritetet kontraktore, kryesisht ato që prokurojnë mallra/punë/shërbime në kuadër të veprimtarisë së ceremonialit zyrtar. Në këtë udhëzim u krijua Shtojca për prokurimet në kuadër të veprimtarisë së ceremonialit zyrtar, prokurim, i cili nuk zhvillohet në sistemin e prokurimit elektronik, por në rrugë shkresore.

Nga ana tjetër, nisur nga ankesat e shumta nga operatorët ekonomikë, mbi zhvillimin nga autoriteti kontraktor të kësaj procedure prokurimi në ditë pushimi, u pa e nevojshme që në këtë udhëzim, të bëheshin disa shtesa lidhur edhe me këtë fakt, duke qartësuar se hapja dhe zhvillimi i kësaj procedure prokurimi, nuk duhet të bëhet në ditë pushimi.

Po kështu, u parashikua që afati i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në ftesën për ofertë, brenda të cilit ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit kontraktor, nuk duhet të përkonte në ditë pushimi.

Duke qenë se, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë procedura të thjeshtuara, nisur nga kërkesat e shumta për sqarim nga autoritete të ndryshme kontraktore, lidhur me zbatimin e nenit 56 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, mbi zbatimin e formulës për ofertat anomalisht të ulëta, u pa e nevojshme që të sqarohej edhe ky moment. Pikërisht, në këtë Udhëzim u sqarua se, dispozita e mësipërme ligjore nuk zbatohet në rastin e prokurimeve me vlerë të vogël.

❖ **Udhëzimi Nr. 2, datë 14.06.2016 "Për një shtesë në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 7, datë 22.05.2015 "Për veprimet e Njesisë së Prokurimit në sistemin e prokurimit Elektronik".**

Gjatë vitit 2016, Agjencia e Prokurimit Publik është ndeshur vazhdimisht me problematikën e moszbatimit në praktikë, nga autoritetet kontraktore, të vendimeve të dhëna nga Komisioni i Prokurimit Publik për procedura të caktuara prokurimi.

Në këtë kontekst, për të udhëzuar autoritetet kontraktore mbi mënyrën e zbatimit të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik në sistemin e prokurimit elektronik, në rastin kur procedura e prokurimit ishte anuluar nga autoriteti, u hartua ndryshimi përkatës në udhëzimin e mësipërm.

Nëpërmjet këtij udhëzimi, përcaktohet mënyra e rikthimit në sistemin e prokurimit elektronik të procedurave të anuluar, me qëllim që të bëhet e mundur zbatimi i vendimeve të dhëna nga Komisioni i Prokurimit Publik.

❖ **Udhëzimi Nr. 3, datë 24.10.2016 “Mbi deklarin e konfliktit të interesit nga Zyrtarët e Prokurimit”**

Në ushtrim të detyrave të saj, sipas parashikimeve të 13 të LPP dhe në mbështetje të neneve 56 dhe 64 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Sektori Juridik punoi për hartimin e Udhëzimit “Mbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit nga Zyrtarët e Prokurimit”, i cili ka si qëllim të ndihmojë zyrtarët e prokurimit gjatë procesit të deklarimit të gjendjes së tyre të konfliktit të interesit.

Duke qenë se deklarimi i gjendjes së konfliktit të interesave bëhet sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, APP kërkoi bashkëpunimin e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në drejtim të dhënies së një mendimi nga ana e këtij institucioni, mbi projektin e hartuar fillimisht.

Pas marrjes së mendimit nga ana e këtij institucioni dhe pasqyrim të propozimit të tyre, u finalizua Udhëzimi Nr. 3, datë 24.10.2016 “Mbi deklarin e konfliktit të interesit nga Zyrtarët e Prokurimit”. Ky Udhëzim shoqërohet me dy shtojca përkatëse, të cilat i vijnë në ndihmë zyrtarëve të prokurimit pranë autoriteteve kontraktore lidhur me deklarimin e gjendjes së tyre të konfliktit të interesit.

❖ **Dokumentat Standarde të Tenderit**

Në ushtrim të detyrave të saj, APP në mbështetje të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ka rishikuar Dokumentat Standarde të Tenderit për Procedurën e Hapur, Procedurën e Kufizuar, Kërkesë për Propozim, Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës, Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi, për kontratat e furnizimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve publike.

Këto ndryshime u miratuan me Vendimin Nr. 1, datë 29.04.2016 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ndryshimet që pësuan Dokumentat Standarde të Tenderit konsistojnë në rishikimin e Shtojcave të listuara më poshtë:

- a. Shtojca “Njoftimi i kontratës”,
- b. Shtojca “Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes”,
- c. Shtojca “Formulari i Njoftimit të Operatorëve të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër ” ,
- d. Shtojca “Njoftim i Kontratës së Nënshkruar”, si dhe shtojca standarde e këtij formulari që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Shtojcat e mësipërme janë riformuluar në drejtim të shtimit të informacionit, i cili ishte i nevojshëm, si për autoritetin kontraktor ashtu edhe për operatorin ekonomik gjatë përgatitjes së ofertës së tij.

Një risi shumë e rëndësishme e këtyre ndryshimeve është edhe mundësia e identifikimit të shtesave të kontratave, duke kërkuar nga autoritetet kontraktore të lidhin shtesën e kontratës me procedurën mëmë të zhvilluar më parë prej tyre nëpërmjet deklarimit të numrit të saj të identifikimit në njoftimin për kontratën e nënshkruar të dërguar për publikim pranë APP për kontratën shtesë.

Sa më sipër, bën të mundur që të përcaktohet saktë numri i procedurave të reja “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, të zhvilluara nga autoritetet kontraktore me qëllim monitorimin sa më të mirë të tyre nga APP dhe identifikimin e rasteve abuzive të përdorimit të kësaj lloji procedure.

3. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2016

Sfidat kryesore me të cilat është përballur APP, gjatë vitit 2016, kanë konsistuar kryesisht:

- i. në ri-inxhinierimin e sistemit elektronik të prokurimit, me qëllim përmirësimin e tij dhe shtimin e funksionaliteteve për ta bërë sa më të aksesueshëm dhe lehtësisht të përdorshëm nga autoritetet kontraktore, operatorët ekonomikë apo përdorues të tjerë;
- ii. në monitorimin e procedurave të prokurimit publik me qëllim evidentimin e problemeve të hasura dhe mangësive të autoriteteve kontraktore, sa i takon zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe parashikimin e masave të nevojshme për adresimin e tyre;
- iii. në ngritjen e kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik në vend.

Në lidhje me procesin e vazhdueshëm të përmirësimit të prokurimit elektronik, APP, gjatë këtij viti ka punuar intensivisht për ngritjen e kapaciteteve të sistemit, si në pjesën operacionale, ashtu dhe në atë të arkivës. Sfida më e madhe e APP në këtë drejtim ka qenë menaxhimi i ngarkesës së sistemit për shkak të numrit shumë të lartë të procedurave të zhvilluara në të, numër, i cili rritet ndjeshëm për shkak të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në këtë kuptim, pas më shumë se 7 vjetësh zhvillimi në mënyrë elektronike të procedurave të prokurimit, si edhe duke pasur parasysh rritjen e numrit të përdoruesve dhe njëkohësisht rritjen e numrit të procedurave të zhvilluara në sistem, u pa i nevojshëm përmirësimi në tërësi i të gjithë platformës dhe iniciimi i procesit të rinixhinierimit për këtë qëllim.

Procesi i riinxhinierimit konsiston në shtimin e kapaciteteve dhe funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik me qëllim për ta bërë lehtësisht të aksesueshëm dhe të përdorshëm nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Rishtë më të rëndësishme në këtë drejtim janë veçanërisht; (i) futja e kodeve CPV, nëpërmjet të cilave bëhet i mundur klasifikimi i procedurave të prokurimit sipas fushave që në fillim të procesit duke u krijuar mundësinë operatorëve ekonomikë të identifikojnë lehtësisht procedurat e prokurimit për të cilat kanë interes, dhe (ii) mundësimi për operatorët ekonomikë i ofertimit nëpërmjet smartphone që përdorin sisteme operacionale iOS dhe Android në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël duke rritur kështu mundësitë për ofertim sidomos për bizneset e vogla dhe mesme që janë ofertuesit më të mëdhenj në këto lloj procedurash.

Sistemi i përmirësuar do të bëhet plotësisht funksional dhe do të lanohet gjatë gjysmës së parë të vitit 2017. Më tej në këtë analizë do të përshkruhen të gjitha ndryshimet që pritet të pësojë ky sistem.

Edhe këtë vit, një nga sfidat kryesore për APP ka qenë monitorimi i procedurave të prokurimit publik të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, i cili sikurse edhe më parë ka pasur në fokus procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për shkak të natyrës dhe mënyrës jo transparente të zhvillimit të tyre.

Gjithashtu, një vend të rëndësishëm në procedurat e monitoruara zënë edhe procedurat e denoncuar në portalin “Stop Korrupsionit”, të cilat këtë vit kanë kaluar në monitorim menjëherë me t’u konstatuar nga APP se kanë përfunduar me nënshkrimin e një kontrate, pa prituri të përfshihen në planin e rradhës të monitorimit.

Qëllimi i procesit të monitorimit ka qenë evidentimi i shkeljeve procedurale, si në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në fazën e përgatitjes dhe vlerësimit të procedurës konkrete. Me vendimet e marra në përfundim të procedurave monitoruese, APP ka synuar jo vetëm marrjen e masave ndëshkimore për personat përgjegjës që kanë shkelur legjislacionin e prokurimit publik, por edhe dhënien e rekomandimeve dhe udhëzimeve përkatëse autoriteteve kontraktore të monitoruara, për shmangien në të ardhmen të problematikave dhe shkeljeve të konstatuara.

Në këtë kuptim, procesi i monitorimit në vetvete është një nga mekanizmat më të rëndësishëm për të garantuar rritjen e përgjegjshmërisë në autoritetet kontraktore dhe zbatueshmërisë së ligjit nga ana e tyre, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e efikasitetit të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi. Të dhëna më të detajuara mbi procesin e monitorimit do të jepen në vijim të kësaj analize.

Gjatë vitit 2016, një sfidë për APP ka qenë edhe përfaqësimi në çështje gjyqësore, ku ka qenë palë, kjo sidomos për shkak të numrit të lartë të vendimeve të APP të ankimuara në gjykatë. Megjithatë, treguesit e ardhur nga statistikat në këtë drejtim janë shumë pozitivë për veprimtarinë dhe vendimmarrjen e APP. Të dhëna të detajuara në këtë drejtim do të jepen në vijim të kësaj analize.

Një tjetër sfidë gjatë këtij viti ka qenë edhe trajnimi i autoriteteve kontraktore mbi zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, në kushtet kur numri i kërkesave për këto trajnime ka qenë shumë i lartë.

4. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

4.1. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE HOMOLOGE TË VENDEVE TË RAJONIT DHE TË BE-SË

Gjatë vitit 2016, APP ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione homologe ndërkombëtare. Në këtë kuadër, përfaqësues nga APP kanë marrë pjesë në takime ndërkombëtare, si dhe kanë pritur delegacione me përfaqësues të institucioneve homologe në rajon.

Një nga institucionet kryesore, me të cilët APP ka pasur një bashkëpunim shumë të rëndësishëm edhe gjatë këtij viti ka qenë SIGMA, një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE, me të cilën është bashkëpunuar në disa drejtime, konkretisht:

- (i) në kuadër të procesit të përgatitjes së Pasaportës të Indikatorëve për matjen e progresit të arritur në zbatimin e strategjisë për menaxhimin e financave publike, APP ka punuar me ekspertët e SIGMA për të përcaktuar indikatorët që lidhen me fushën e prokurimit publik;
- (ii) sikurse edhe në vitet e mëparshme, SIGMA ka vijuar të japë ndihmesën e saj në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e prokurimit publik dhe përafrimit të tij me direktivat përkatëse të BE. Në këtë kuptim, me ndihmesën e SIGMA-s është përkthyer direktiva 2009/81/KE për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me qëllim vijimin e punës për përafrimin e kësaj direktive. Gjithashtu, ekspertët e SIGMA-s kanë dhënë një ndihmesë shumë të rëndësishme edhe sa i takon informacioneve të nevojshme lidhur me eksperiencat e vendeve anëtare të BE-së në procesin e transpozimit të kësaj direktive.
- (iii) së fundmi, me kërkesë të Delegacionit të BE-së në Tiranë, në fund të vitit SIGMA është bërë pjesë e grupit të punës të ngritur për ndryshimin e ligjit për prokurimin publik me qëllim përmirësimin e sistemit të ankimimit dhe sidomos riorganizimin e Komisionit të Prokurimit Publik duke luajtur një rol shumë aktiv në hartimin e këtyre ndryshimeve, të cilat pritet të miratohen brenda gjashtëmuajorit të parë 2017

Po kështu, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht edhe me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, duke zhvilluar edhe takime të vazhdueshme me përfaqësues të këtij institucioni, si në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga MSA, ashtu edhe në kuadër të implementimit të disa strategjive kryesore të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, pjesë e të cilave

është edhe prokurimi publik si, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, Strategjia Kombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe Strategjia ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike.

Një bashkëpunim shumë të mirë gjatë këtij viti, APP ka pasur edhe me përfaqësinë e Bankës Botërore në Shqipëri. Përveç pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme, të organizuara nga kjo e fundit, dhe implementimit të aktiviteteve të projektit “Përmirësimi i kontrollit të përputhshmërisë dhe rritja e transparencës në prokurimin publik në Shqipëri” siç është shpjeguar më sipër, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me këtë institucion në kuadër të procesit të vlerësimit të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, duke vendosur në dispozicion të tyre të gjitha informacionet e kërkuara gjatë këtij procesi.

Gjithashtu, përfaqësues të Bankës Botërore në Tiranë kanë qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e ndryshimeve ligjore për riorganizimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

4.2. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA NË SHQIPËRI

Edhe gjatë vitit 2016, APP ka patur një bashkëpunim të ngushtë me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga APP janë dhënë sqarime dhe këshilla për këto institucione, sipas kërkesave, me qëllim zbatimin sa më korrekt të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat dhe atij të ankandit publik.

Një bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv, APP ka vazhduar të ketë dhe gjatë vitit 2016 me Ministrinë e Integritit. Në këtë kuptim, APP ka raportuar në mënyrë periodike pranë kësaj Ministrie mbi progresin e arritur në drejtim të zbatimit të angazhimeve që janë marrë me nënshkrimin e MSA, në fushën e prokurimeve publike. Në këtë kuadër, janë realizuar takime të shpeshta me këtë Ministri, të cilat kanë patur si objektiv konsultimin e specialistëve me qëllim realizimin e objektivave në kuadër të integritit.

Në kuadër të raportimit të mësipërm dhe ndjekjes së aktiviteteve të tjera lidhur me procesin e integritit, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht edhe me Komisionin e Prokurimit Publik, Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme dhe DSIK, si institucione anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 5.

Ndër të tjera, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, APP ka vijuar bashkëpunimin me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik sikurse edhe në vitet e kaluara sidomos për sa i takon njoftimeve të dërguara nga KPP në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e mëtejshëm nga ana e autoriteteve kontraktore siç

parashikohet edhe në dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik. Gjithashtu, ky bashkëpunim evidentohet edhe në rastin e pasqyrit të sistemit të prokurimit elektronik të vendimeve të dhëna nga KPP, në përfundim të shqyrtimit të ankesave.

Gjithashtu, në kuadër të implementimit të planit të masave për Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike, Strategjinë Kombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe Strategjinë ndërsektorale të Reformës në Administratën Publike, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet përgjegjëse për koordinimin e tyre dhe konkretisht, Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Për sa më sipër, APP ka raportuar në mënyrë periodike lidhur me statusin e zbatimit të masave respektive për këto strategji dhe ka marrë pjesë rregullisht në takimet e zhvilluara për këtë qëllim.

Një ndër institucionet kryesore, me të cilin APP ka vijuar të ketë një bashkëpunim të mirë edhe gjatë vitit 2016 është Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), në bashkëpunim me të cilën ka realizuar disa trajnime për autoritetet kontraktore, me qëllim njohjen e tyre me kuadrin ligjor dhe përmirësimet e sistemit të prokurimit elektronik.

Një tjetër bashkëpunim intensiv gjatë vitit 2016, APP ka pasur me institucionet audituese, ku ndër më kryesorët ka qenë Kontrolli i Lartë i Shtetit, me qëllim evidentimin dhe penalizimin e shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit nga autoritete të ndryshme kontraktore.

5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË SEKTORIT JURIDIK PRANË DREJTORISË JURIDIKE DHE MONITORIMIT

Në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, Sektori Juridik pranë APP e ushtron veprimtarinë e tij duke u fokusuar kryesisht (i) në hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore, si dhe udhëzimeve për unifikimin e praktikave në fushën e prokurimit publik, (ii) në dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, (iii) në dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, si dhe (iv) në shqyrtimin e propozimeve për përjashtimin e shoqërive të ndryshme nga e drejta për të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve publike, koncesioneve/partneritetit publik privat apo procedurat e ankandeve.

Më konkretisht, gjatë vitit 2016, Sektori Juridik e përqëndroi veprimtarinë e tij në këto drejtime kryesore:

5.1. HARTIMI I AKTEVE NËNLIJORE DHE UDHËZIMEVE

Sikurse është përmendur edhe më sipër në këtë Analizë, gjatë vitit 2016, Sektori Juridik ka punuar për hartimin e disa udhëzimeve me qëllim për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, ky sektor ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e Dokumentave Standarde të Tenderit, për t'i bërë ato më lehtësisht të zbatueshme nga ana e autoriteteve kontraktore.

5.2. PRAKTIKAT E SHQYRTUARA PËR DHËNIE MENDIMESH, KËSHILLA APO UDHËZIMESH GJATË KËTJ VITI

Sektori Juridik, në zbatim të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fushën e prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, lidhur me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore apo operatorëve ekonomikë, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore apo edhe të operatorëve ekonomike për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit.

Asistenca e dhënë nga ky sektor është përqendruar në mirëzbatimin e rregullave të prokurimit dhe këshillimin ligjor për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, por në disa raste edhe të procedurave të ankandit publik.

Një numër i konsiderueshëm kërkesash për dhënie mendimi gjatë këtij viti, janë përqendruar në dhënie këshillimi ligjor apo asistencë autoriteteve të ndryshme kontraktore, lidhur me prokurimin e shërbimit privat të ruajtjes me roje, sa i takon mbulimit të nevojave të tyre për këtë shërbim, deri në përfundimin e shqyrtimit të procedurës së ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, procedurë kjo e zgjatur në kohë nga ana e këtij institucioni.

Kjo ka sjellë edhe rritjen e numrit të përdorimit të procedurës së prokurimit “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pasi autoritetet kontraktore kanë qenë të detyruar që deri në përfundimin e shqyrtimit të procedurës së ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, t’a përdorin këtë lloj procedure prokurimi për mbulimin e nevojave të tyre. Theksojmë se, ky fakt nuk është konstatuar vetëm në prokurimin e shërbimit privat të ruajtjes me roje, por edhe në objekte të tjera të prokuruar, të cilat kanë qenë në proces ankimimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga ana tjetër është hasur problematika e moszbatimit në praktikë nga autoritetet kontraktore të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të procedurës së ankimimit për një procedurë prokurimi.

Në të shumtën e rasteve, këto vendime nuk janë respektuar nga autoritetet kontraktore, të cilët anullojnë procedurën e prokurimit për të cilën është dhënë vendimi, duke zgjatur kështu pa asnjë arsye ligjore finalizimin e procedurës së prokurimit dhe marrjen e shërbimit/mallit apo punës, objekt prokurimi.

Nga ana tjetër, pavarësisht parashikimit të nenit 38/1 të LPP, sipas të cilit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nuk zbatohen dispozitat e ankimimit administrativ, operatorët ekonomikë, në cilësinë e ofertuesve, kanë vijuar me ankimime të shumta.

Në rastet, kur është gjykuar se autoriteti kontraktor ka vepruar në shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, veprimtaria e autoriteteve kontraktore të kontestuara është bërë subjekt monitorimi nga APP pas fazës së nënshkrimit të kontratës, pikërisht në bazë të këtyre ankesave apo denoncimeve të paraqitura.

Vlen të theksojmë këtu se ankesa apo denoncime ka patur edhe për lloje të tjera të procedurave të prokurimit, ku ankuesit janë orientuar që të ndjekin shkallët e ankimimit pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Komunikimet shkresore të Sektorit Juridik gjatë vitit 2016, kanë qenë kryesisht me:

- (i) Autoritete të ndryshme kontraktore dhe operatorë ekonomikë, të cilët kanë kërkuar mendime apo sqarime mbi çështje në fushën e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve dhe ankandit publik;
- (ii) Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre mbi procedurat e prokurimit të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore;
- (iii) Operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilët kanë kërkuar të pajisen me vërtetime që të pasqyrojnë gjendjen e tyre si operatorë që nuk janë përjashtuar me një vendim të APP nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik;
- (iv) Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar mbi verifikimin e kërkuar për operatorë ekonomikë të caktuar, nëse ka patur një vendim përjashtimi për to nga APP.

Konkretisht, numri total i praktikave të paraqitura në këtë sektor për mendim, sqarim apo informacione, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve dhe ankandeve publike gjatë vitit 2015 është 268.

Në formë tabelore këto të dhëna janë si më poshtë:

Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi	Verifikime të kërkuara nga DSIK	Vërtime të lëshuara për operatorët ekonomikë që nuk janë në proces përjashtimi	Kërkesa të paraqitura nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor
177	17	58	16

Gjithashtu, gjatë vitit 2016, Sektori Juridik ka dhënë mendime edhe për projektvendime të ndryshme. Numri total i projektvendimeve të shqyrtuara është **8 (tetë)**.

5.3. SHQYRTIMI I PROPOZIMEVE PËR PËRJASHTIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË

Një kompetencë tjetër ligjore e APP, ushtruar nëpërmjet këtij sektori gjatë vitit 2016, ka qenë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore apo operatorëve ekonomikë, për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi, koncesioneve/PPP-ve apo procedura ankandi, për një periudhë të caktuar kohore.

Konkretisht gjatë vitit 2016 janë marrë në shqyrtim **40 kërkesa** për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nga të cilat ka filluar procedimi administrativ për përjashtimin nga procedurat e prokurimit për **25 operatorë ekonomikë**.

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, është marrë vendimi për përjashtimin nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime, për **6 (gjashtë)** operatorë ekonomikë, nga të cilët:

- **2 (dy)** Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të keqinformimit, nëpërmjet paraqitjes në tender të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- **3 (tre)** Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/ç të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- **1 (një)** Operator Ekonomik, është përjashtuar në zbatim të vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor.

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur nga APP, është marrë vendim për mos përjashtimin nga prokurimet publike për:

- **9 (nëntë)** Operatorë Ekonomikë, pasi në bazë të dokumentacionit të administruar nuk është provuar se kanë qenë në kushtet e parashikuara në nenin 13 të LPP për përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në prokurimet publike .

Ndërkohë, gjatë procedimit administrativ të nisur për përjashtimin e operatorëve ekonomikë për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale është konstatuar se zgjidhja e çështjes së paraqitur për përjashtim ka qenë në kompetencë të Gjykatës, pasi mospërmbushja e detyrimit kontraktual të pretenduar ka qenë objekt i kërkesë padisë së ngritur pranë kësaj Gjykate. Në këto kushte:

- Për **3 (tre)** operatorë ekonomikë nga APP është marrë vendim për pezullimin e procedimit administrativ, deri sa gjykata të shprehet me vendim përfundimtar për këto çështje.

Procedimi administrativ i nisur nga APP është ende në proces për **7 (shtatë)** operatorë ekonomikë.

Ndërkohë, për **15 (pesëmbëdhjetë)** operatorë ekonomikë, APP nuk ka nisur procedimin administrativ, pasi kërkesa e paraqitur nga propozuesit është konsideruar me dokumentacion të pamjaftueshëm dhe e paargumentuar për të filluar procedimin administrativ, si dhe në disa raste ju është kërkuar plotësim i dokumentacionit, sipas kushteve të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

TOTALI 40 kërkesa për përjashtim				
Vendime përjashtimi	Vendime mos përjashtimi	Procedime administrative të pezulluara	Procedime administrative në proces	Kërkesa të paplota
6	9	3	7	15

3 (tre) nga vendimet e APP për përjashtim janë ankimuar nga pala e prekur nga vendimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Tiranë, nga të cilat:

- **për 1 (një)** operator ekonomik është pranuar pjesërisht kërkesë padia, duke u ulur dënimin në 1 vit.
- **për 2 (dy)** operatorë ekonomikë është rrëzuar kërkesë padia.

Ankimuar në gjykatë	Rrëzuar kërkesë padia	Pranuar pjesërisht kërkesë padia
3 vendime të APP	2 vendime	1 vendim (duke ulur masën e dënimit në 1 vit)

5.4. PËRFAQËSIMI NË PROCESET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2016, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur kryesisht nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të dënuar me gjobë në përfundim të procesit të monitorimit, si dhe në procese gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë.

Gjithsej në vitin 2016, nga APP janë ndjekur 108 çështje gjyqësore, nga të cilat 88 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, 13 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe 7 çështje në Gjykatën e Lartë.

Çështje gjyqësore në total	Në Gjykatën Admin. Shk. e Parë	Në Gjykatën Admin. Apel	Në Gjykatën e Lartë
108	88	13	7

Nga **88** çështjet gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë:

- **3** çështje janë kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë;
- **85** çështje janë për vendime të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit;

Çështje gjyqësore në Gjykatën Admin. Shk. e Parë	Kundër vendimeve të APP për përjashtimin e op. ek.	Kundër vendimeve të APP për dënimin me gjobë
88	3	85

Nga **3** çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë:

- për **2** çështje është rrëzuar kërkesë padia;
- për **1** çështje është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesë padisë duke ulur masën e dënimit për përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik në 1 (një) vit.

Çështje kundër vendimeve të përjashtimit	Rrëzuar kërkesë padia	Pranimi pjesërisht i kërkesë padisë
3	2	1

Nga **85** çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit, **74** çështje kanë përfunduar në shkallë të parë, dhe konkretisht Gjykata ka vendosur:

- në **34** çështje pranimin e kërkesë padisë;
- në **31** çështje rrëzimin e kërkesë padisë;
- në **2** çështje mospranimin e kërkesë padisë;
- në **2** çështje është vendosur pushimi;
- në **5** çështje është vendosur pranim pjesërisht i kërkesë padisë;
- Ndërkohë **11** çështje janë ende në proces.

TOTALI					
85 Çështje kundër vendimeve të dënimit me gjobë					
Pranuar kërkesë padia	Rrëzuar kërkesë padia	Mospranimi i kërkesë padisë	Pranimi pjesërisht i kërkesë padisë	Pushimi i çështjes	Në proces
34	31	2	5	2	11

Nga **74** vendimet gjyësore për çështjet e përfunduara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, **61** vendime të dhëna nga kjo gjykatë kanë qenë të formës së prerë.

Ndërkohë, **13** vendime gjyqësore janë apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, nga të cilat:

- **8** vendime janë apeluar nga APP dhe
- **5** vendime janë apeluar nga pala tjetër ndërgjyqëse.

Vendime gjyqësore të apeluara	Apeluar nga APP	Apeluar nga pala tjetër ndërgjyqëse
13	8	5

Nga **13** çështjet e apeluara në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, janë përfunduar me vendim të formës së prerë **4** çështje, dhe janë ende në proces **9** çështje.

Vendime gjyqësore të apeluara	Përfunduar me vendim të formës së prerë	Në proces
13	4	9

Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë në **7 çështje** në Gjykatën e Lartë, të cilat janë ende në proces.

Në rastin e fletëthirrjeve për t'u paraqitur si palë ndërgjyqëse në gjykatat administrative në rrethe, APP iu është drejtuar këtyre të fundit me kërkesë për shpalljen e moskompetencës, sipas ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Konkretisht, kanë ardhur fletëthirrje për **19** çështje gjyqësore nëpër rrethe, të cilave i është dërguar kërkesa për shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e çështjeve për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Vetëm në **5** raste këto gjykata kanë pranuar kërkesën e APP për shpalljen e moskompetencës tokësore, ndërsa në **14** çështje gjykatat e rretheve kanë refuzuar kërkesën e APP për shpalljen e moskompetencës dhe kanë vazhduar me gjykimin e saj.

Çështje gjyqësore në rrethe	Pranim kërkesë për shpallje moskompetence	Refuzim kërkesë për shpallje moskompetence
19	5	14

6. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË MONITORIMIT PRANË DREJTORISË JURIDIKE DHE MONITORIMIT

Në zbatim të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni i prokurimit publik, veprimtaria e Sektorit të Monitorimit fokusohet në dy drejtime kryesore (i) verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/PPP dhe ankandëve publike, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit dhe (ii) shqyrtimi i raporteve të organeve të ndryshme audituese si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetsor, Audite të Brendshme të institucioneve apo vendime të Komisionit të Prokurimit Publik, ku pasqyrohen përkatësisht gjetjet për procedurat e prokurimit të audituara dhe rekomandimet përkatëse.

6.1 MONITORIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT NGA APP

Gjatë vitit 2016, në APP (në adresën elektronike apo në rrugë shkresore) janë paraqitur denoncime nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilët kanë kundërshtuar veprimet e autoriteteve kontraktore në procedura të caktuara prokurimi të ndërmarra prej tyre, duke pretenduar për shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit publik.

Gjithashtu, denoncime të ndryshme ka pasur edhe në portalin www.stopkorrupsionit.al, të cilat i janë adresuar për ndjekje APP.

Denoncimet e operatorëve ekonomikë kanë konsistuar kryesisht në drejtim të hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të pranimi nga autoritetet kontraktore, duke pretenduar për paracaktimin e fituesit nga këto të fundit, por edhe për vlerësim të padrejtë të ofertave.

Dhet theksuar se, gjatë këtij viti, janë shtuar denoncimet për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, duke marrë në konsideratë faktin që rritja e kufirit monetar për këto lloj procedurash (nga 400,000 në 800,000 lekë pa Tvsh) ka rritur interesin e operatorëve ekonomikë, përfshirë biznes i vogël dhe i mesëm, për të ofertuar.

Mbi këtë bazë, procedurat e prokurimit të denoncuara, të cilat pas verifikimeve përkatëse në sistemin e prokurimit elektronik kanë rezultuar të jenë finalizuar me kontratë të nënshkruar, i janë nënshtruar procesit të verifikimit, duke u përfshirë në planet e monitorimit apo verifikimit të menjëhershëm të tyre.

Fillimisht, në muajt Janar-Shkurt të këtij viti është mbyllur monitorimi për 6 (gjashtë) procedura prokurimi të zhvilluara nga 5 (pesë) autoritete kontraktore, të cilat kanë qenë të përfshira në planin paraardhës të monitorimit të vitit 2015.

Ndërkohë në Muajin Mars është hartuar Plani i parë i Monitorimit, ku janë përfshirë 31 (tridhjetenjë) procedura prokurimi, të denoncuara, si dhe procedura të tjera prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, me përzgjedhje.

Në këtë plan janë përfshirë për monitorim, kryesisht, procedura prokurimi të llojit “Negociim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës”. Kjo lloj procedure prokurimi ka vijuar të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, si një procedurë e veçantë, që përdoret në rrethana të caktuara, të parashikuara në dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Duke qenë se, procedura e prokurimit “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” është një procedurë, që nuk kërkon njoftim publik, pra nuk lejon pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë (përveç atyre të ftuar nga autoriteti kontraktor) dhe zhvillohet në rrugë shkresore, mund të bëhet abuziv përdorimi i saj nga Autoritetet Kontraktore, duke çuar në shmangien e konkurrencës ose diskriminim të kandidatëve.

Në këtë kuadër, nga të dhënat e nxjerra nga Buletini i Njoftimeve Publike (njoftimet e kontratave të nënshkruara të publikuara në këtë buletin, gjatë vitit 2015), duke marrë për bazë fondin limit dhe natyrën e objektit të prokurimit, u përzgjedhën si objekt monitorimi, 10 (dhjetë) procedura prokurimi të llojit “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Gjithashtu, në këtë Plan Monitorimi u përzgjedhën për monitorim, nga të dhënat e nxjerra nga Sistemi i Prokurimit Elektronik, edhe 8 (tetë) procedura të hapura prokurimi, me vlerë të konsiderueshme të fondit limit ose me vlerë të fituar sa/afër vlerës së fondit limit, pra vlera e kursyer në këto procedura ka rezultuar minimaliste.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016, monitorimi i procedurave të prokurimit është fokusuar në drejtim të verifikimit të drejtpërdrejtë të rasteve të denoncuara në portalin antikorrupsion, APP, si dhe rekomandimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, për hetim.

Konkretisht, gjatë kësaj periudhe është kryer verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë për 10 (dhjetë) procedura prokurimi, të denoncuara, të cilat kanë rezultuar të finalizuara me kontratë të nënshkruar.

Procedurat e denoncuar kanë qenë të llojit “Prokurim me vlerë të vogël” në 6 (gjashtë) raste, “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” në 3 (tre) raste dhe “Kërkesë për propozim” në 1 (një) rast.

Gjithashtu, 1 (një) procedurë prokurimi “E hapur” është rekomanduar për monitorim nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në fund të Muajit Tetor është hartuar Plani i dytë i Monitorimit, në të cilin janë përfshirë 21 (njëzetënjë) procedura prokurimi. Në fokusin e këtij plani ka vijuar të jetë monitorimi i procedurave të prokurimit “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Në këtë kuadër, nga të dhënat statistikore të përpunuara nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, duke marrë për bazë fondin limit dhe natyrën e objektit të prokurimit, janë përzgjedhur si objekt monitorimi 17 (shtatëmbëdhjetë) procedura prokurimi të llojit “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Gjithashtu, në këtë Plan Monitorimi janë përzgjedhur për monitorim, nga të dhënat e nxjerra nga Sistemi i Prokurimit Elektronik, edhe 5 (pesë) procedura të hapura prokurimi, të zhvilluara nga autoritete kontraktore, të cilat nuk janë monitoruar së fundmi nga APP. Procedurat janë përzgjedhur mbi bazën e vlerës së konsiderueshme të fondit limit dhe me vlerë të fituar sa/afër vlerës së fondit limit, pra vlera e kursyer në këto procedura ka rezultuar minimaliste.

Në vitin 2016 ka përfunduar monitorimi për 8 (tetë) prej procedurave të prokurimit të përfshira në këtë Plan.

Mbi këtë bazë, në vitin 2016 janë monitoruar në total 56 procedura prokurimi të zhvilluara nga 50 autoritete të ndryshme kontraktore.

Llojet e procedurave të prokurimit të monitoruara nga APP janë si më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri i procedurave të monitoruara
Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit	21
Procedurë e hapur	20
Kërkesë për propozim	3
Procedura prokurimi me vlerë të vogël	12

Në përfundim të procesit të monitorimit, në rastet kur janë konstatuar shkelje të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, APP në varësi të llojit të shkeljes, fondit limit të procedurës së prokurimit, rolit të personit në procedurë, si dhe pasojës së ardhur, ka marrë vendim për dënim me gjobë ose ka propozuar marrjen e masës disiplinore, ndaj personave përgjegjës.

Të dhënat statistikore mbi masat administrative të dhëna nga APP, në përfundim të procesit të monitorimit, nisur nga roli i personit në procedurën e prokurimit të monitoruar, paraqiten në vijim:

Gjoba

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	17
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	21
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	19
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	6

Masa Disiplinore

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	2
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	12
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	9
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	1
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	10

6.1.1. Gjetjet dhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të monitorimit

Gjatë monitorimeve të kryera nga APP janë konstatuar shkelje të ndryshme të dispozitave ligjore të prokurimit publik, në varësi të llojit të procedurës së prokurimit të monitoruar.

Sa i takon procedurës së prokurimit “**Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës**”, synimi i monitorimit të kësaj lloji procedure, ka qenë (i) identifikimi i arsyeve që çojnë një autoritet kontraktor në përzgjedhjen e kësaj lloji procedure (*duke qenë se zhvillimi i saj nuk bëhet në mënyrë transparente dhe konkurruese*), (ii) kontrolli i përmbushjes dhe zbatueshmërisë së kushteve të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik për këtë rast, si dhe (iii) parandalimi i përzgjedhjes së gabuar të kësaj lloji procedure në të ardhmen.

Gjetja kryesore e APP në monitorimin e procedurës së prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, është që në shumicën e rasteve Autoritetet Kontraktore kanë përdorur këtë lloji procedure me pretendimin se janë ndodhur në kushte emergjence për objektin e prokurimit, por nuk justifikojnë rrethanat e paparashikuara, që i çojnë ato në pamundësi për të planifikuar në kohë nevojat e tyre, me qëllim përmbushjen e këtyre të fundit nëpërmjet procedurave konkurruese, sipas parashikimeve ligjore.

Më së shumti është vërejtur mosadministrimi i dokumentacionit të nevojshëm për të provuar dhe argumentuar ekzistencën e kushteve të parashikuara në ligj, për përdorimin e kësaj lloji procedure prokurimi.

Në rastet kur, AK ka pasur mundësi të parashikojë në kohë nevojën, por me mosveprimet e tij, ka sjellë “krijimin e një situatë emergjente”, përzgjedhja e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është konsideruar në shkelje të dispozitave ligjore për prokurimin publik në fuqi dhe janë penalizuar personat përgjegjës sipas parashikimeve.

Përveç përzgjedhjes së gabuar të kësaj lloji procedure, sikurse kemi analizuar më sipër, një tjetër shkelje e konstatuar nga APP, ka qenë lidhja e kontratave afatgjata, ndërkohë që legjislacioni në fuqi, përcakton në mënyrë të qartë mundësinë e përdorimit të kësaj procedure, vetëm për të zgjidhur situatat emergjente, duke ndaluar shprehimisht lidhjen e kontratave afatgjata.

Gjithashtu, ka pasur raste kur autoritetet kontraktore kanë përzgjedhur procedurën “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pas dështimit të njëpasnjëshëm të dy procedurave normale të prokurimit. Në rastet e monitoruara është evidentuar se përzgjedhja e kësaj lloji procedure është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit, pasi në

procedurat e mëparshme ka pasur oferta të paraqitura, por këto oferta kanë rezultuar të pasuksesshme. Ndërkohë, dispozitat ligjore të prokurimit lejojnë përdorimin e kësaj lloji procedure prokurimi, kur autoritetet kontraktore nuk kanë mundur të realizojnë dy procedura normale të njëpasnjëshme për shkak të mosparaqitjes së asnjë oferte në këto procedura.

Për më tepër, sikurse parashikohet nga dispozitat përkatëse ligjore, për çdo rast të dështimit të një procedure normale prokurimi, Autoritetet Kontraktore duhet të analizojnë shkaqet që kanë çuar në këtë dështim, për të mundësuar realizimin me sukses të procedurës, me rishpalljen e saj, gjë që nuk ka rezultuar të jetë bërë në procedurat e prokurimit të monitoruara.

Problematikë kryesore e ndeshur në mënyrë të vazhdueshme gjatë monitorimit të procedurave të prokurimit (*pavarësisht llojit të procedurës*) është **mosargumentimi dhe dokumentimi i përlllogaritjes së fondit limit**, kryesisht në procedurat e prokurimit të punëve publike, por jo vetëm.

Në lidhje me **përlllogaritjen e fondit limit në kontratat e punëve publike** janë evidentuar parregullsitë si në vijim:

→ Në rastin kur, fondi limit është hartuar nga një strukturë brenda Autoritetit Kontraktor (*Njësia e Prokurimit ose Grup Pune i ngritur nga Titullari, për këtë qëllim*), nuk janë dokumentuar referencat e çmimeve njësi të përdorura dhe/ose nuk janë hartuar analiza çmimi për zërat e punimeve, për të cilat nuk gjenden çmime në manualet përkatëse të çmimeve zyrtare.

Vërehet se, në disa raste, çmimet e përdorura në hartimin e preventivit dhe përlllogaritjen e fondit limit, nuk përputhen me çmimet në manualet përkatëse edhe pse si referenca shënohen numrat e analizave në këto manuale, duke sjellë kështu një rritje fiktive të vlerës së fondit limit.

Gjithashtu, në shumë raste, edhe pse Autoriteti Kontraktor ka hartuar analiza teknike për çmimet njësi të zërave, për të cilat nuk gjenden çmime në manualet përkatëse, nuk dokumentohen çmimet e nënçrave (materialeve, mjeteve, orëve të punës etj.) të përdorura në analizat përkatëse. Kjo gjë bën që një analizë e tillë të mos pasqyrojë të gjithë informacionin e plotë mbi referencat, në bazë të të cilave është përlllogaritur çmimi njësi, rrjedhimisht dhe vlera e fondit limit.

→ Në rastin kur fondi limit është hartuar nga një subjekt i licencuar jashtë Autoritetit Kontraktor, nuk autorizohet një person ose grup pune nga Titullari, për të marrë në dorëzim

preventivin e punimeve dhe për të verifikuar përputhshmërinë e tij me dispozitat ligjore në fuqi.

Mosverifikimi paraprak nëse preventivat e hartuar nga subjektet e licencuara janë konform legjislacionit në fuqi bën që preventivi të pranohet i mirëqenë nga Autoriteti Kontraktor, pavarësisht se në të mund të ketë çmime, të cilat janë më të larta se çmimet e manualeve përkatëse.

Në shumë raste është konstatuar se, subjekti i licencuar dorëzon në Autoritetin Kontraktor vetëm preventivin dhe nuk e shoqëron me analizat e çmimeve për çmimet njësi të zërave, për të cilat nuk gjenden çmime në manualët përkatëse.

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktor pranon nga subjekti i licencuar, një preventiv ku vlera e punimeve mund të jetë rritur fiktivisht nga rritja e çmimeve të zërave të veçantë, ose një preventiv, ku nuk dokumentohet referenca e disa prej çmimeve njësi të përdorura për përlogaritjen e fondit limit.

→ Mangësi dhe parregullsi në përlogaritjen e fondit limit janë evidentuar edhe në prokurimin e kontratave të furnizimit të *mallrave dhe shërbimeve*. Përgjithësisht, ka rezultuar se Autoritetet Kontraktore nuk kanë argumentuar dhe dokumentuar mënyrën e përlogaritjes së fondit limit për këto kontrata.

Në lidhje me **kriteret e pranimit**, në mënyrë të vazhdueshme është konstatuar se, Autoritetet Kontraktore përcaktojnë kritere, të cilat nuk janë në raport me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe nxitjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit, në kundërshtimet me parimet dhe qëllimet kryesore të legjislacionit të prokurimit publik.

Më e theksuar kjo gjë është vërejtur në prokurimin e kontratave të punëve publike, ku ka rezultuar se Autoritetet Kontraktore përcaktojnë si kriter kualifikimi që ofertuesit të zotërojnë kategori licence, të cilat nuk përputhen me natyrën dhe vlerën e punimeve objekt kontrate dhe janë në kundërshtim me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar”.

Vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë mbetet gjithashtu, një problematikë për Autoritetet Kontraktore, të cilat, në të shumtën e procedurave të monitoruara ka rezultuar të

kualifikojnë operatorë ekonomikë me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim.

6.2. SHQYRTIMI I RAPORTEVE AUDITUESE

Gjatë vitit 2016, APP ka shqyrtuar raporte të institucioneve të ndryshme audituese, të cilat kanë pasqyruar shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit publik, për procedura prokurimi të audituara nga këto institucione.

Shkeljet kryesore të evidentuara më së shumti gjatë shqyrtimit të këtyre raporteve konsistojnë në: (i) mosargumentimin dhe dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit të objekteve që prokurojnë, (ii) hartimin e kriterëve të pranimit, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, si dhe (iii) vlerësim të gabuar të ofertave të paraqitura.

Konkretisht, gjatë vitit 2016, APP ka marrë në shqyrtim **49** raporte të organeve audituese, për të cilat në **46** raste ka konkluduar në dhënien e masës administrative (*gjobë ose propozim për masë disiplinore ndaj personave përgjegjës*), në **2** raste gjetjet e pasqyruara në raportet e auditit nuk kanë konsistuar në shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit publik që çojnë në penalizim të personave dhe në **1** rast ka rezultuar se procedurat e prokurimit të monitoruara nga Auditi nuk janë zhvilluar sipas legjislacionit shqiptar, për pasojë nuk ka qenë kompetencë e APP shqyrtimi i gjetjeve në këtë rast.

Të dhënat statistikore mbi raportet e shqyrtuara dhe masat administrative të dhëna nga APP, në përfundim të shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, në varësi të rolit të personit në procedurat e prokurimit të audituara, paraqiten në vijim:

Raportet e Auditit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Kontrolli i Lartë i Shtetit	29
Audite të Brendshme të Institucioneve	10
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetsor	5
Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik	4
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier	1
Totali	49

Nisur nga roli i zyrtarit në procedurë, masat administrative të dhëna nga APP rezultojnë si më poshtë:

Gjoha:

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	7
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	9
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	22
Anëtar i Grupit për Përlogaritjen e Fondit Limit	10

Masa disiplinore të propozuara:

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	7
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	28
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	6
Anëtar i Grupit për Përlogaritjen e Fondit Limit	3
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	2
Anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave	1

7. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PUBLIKIMEVE

7.1. SEKTORI I PUBLIKIMEVE

Sektori i Publikimeve gjatë vitit 2016 ka publikuar në total 52 Buletine të Njoftimeve Publike me një numër faqesh në total prej 22,900, ose mesatarisht 440 faqe për javë.

Përveç punës për përmbledhjen e informacionit për publikimin e Buletinit të Njoftimeve Publike punonjësit e ngarkuar me kryerjen e publikimit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në miratimin e njoftimeve të kontratave të hedhura nga Autoritetet Kontraktore, me qëllim publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik. Ky publikim kryhet ditën e nesërme të punës në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sikurse e kërkon legjislacioni i prokurimit publik në fuqi dhe në Buletinin vijues.

Konkretisht, gjatë vitit 2016 janë miratuar për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike:

7.1.1. Njoftime për Procedura

- 5116 Njoftime Kontratash të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit të rishpallura;
- 41 Njoftime për Marrëveshje Kuadër;
- 5,067 Njoftime Fituesi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit;
- 39 Njoftime Fituesi për Marrëveshje Kuadër;
- 4,014 Njoftime Kontratash të Nënshkruara;
- 2,186 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake;
- 490 Njoftime Kontratash të Nënshkruara brenda Marrëveshjeve Kuadër;

- 493 Njoftime Anullimi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit.
- **2200** Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit. Gjatë vitit 2016 është ndjekur ky zbatim i rreth 737 procedura prokurimi dhe vlen të cilësohet se në total janë rreth 1430 vendime pezullimi, lejimi për vazhdim si dhe 770 vendime të ndërmjetme.

7.1.2. Njoftime për Ankande Publike

- 597 Njoftime për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 147 Njoftime Fituesish për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 39 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 172 Njoftime Anullimi për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 114 Njoftime Ankandesh për efekt të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- 33 Njoftime për qera.

7.1.3. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat

- 7 Njoftime Kontratash për Procedura Koncesioni;
- 5 Njoftime Fituesish për Procedura Koncesioni;
- 2 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Procedura Koncesioni;
- 73 Njoftime për Procedura konkurruese për dhënie leje minerare;
- 1,274 Njoftime të tjera.

Gjithashtu, gjatë vitit 2016 janë përpunuar rreth 3,500 regjistra, për parashikimin e prokurimeve, realizimin e tyre dhe ndryshimet gjatë vitit nga Autoritetet Kontraktore, në funksion të përpunimit të të dhënave dhe nxjerrjes së statistikave përkatëse.

7.2. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, KONCESIONEVE/PPP DHE ANKANDIT PUBLIK, TË SHPALLURA GJATË VITIT 2016

7.2.1. Statistika për procedurat e prokurimit të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave të prokurimit publik mbi vlerën 800.000 mijë lekë, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik. Gjithashtu, në këtë pjesë do të pasqyrohen dhe të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara.

7.2.1.1. Statistika sipas Njoftimit të kontratës

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2016 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **5,109** (479 më shumë se në vitin 2015).

Më poshtë pasqyrohet në mënyrë të detajuar numri i tyre sipas llojit të procedurës së publikuar.

Njoftime Procedurash Janar-Dhjetor 2016					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	153	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
E hapur Ndërkombëtare	7	E hapur Ndërkombëtare	8	E hapur Ndërkombëtare	
Procedurë e hapur lokale	402	Procedurë e hapur lokale	797	Procedurë e hapur lokale	636

Kërkesë për Propozim	854	Kërkesë për Propozim	1,702	Kërkesë për Propozim	550
Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale	
Negocim me Njoftim		Negocim me Njoftim		Negocim me Njoftim	
TOTALI	1,416	TOTALI	2,507	TOTALI	1,186

7.2.1.2. Statistika sipas llojit të procedurave

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, **të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik** për vitin 2016, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Numri total i procedurave të shpallura të ndarë sipas llojit të procedurave për Periudhën Janar-Dhjetor 2016	
Nr.Total i Procedurave të shpallura	5109
Fondi total limit i procedurave të shpallura	108,230,737,689
Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi nr	153
Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi në vlerë	1,877,694,098
I hapur ndërkombëtar nr	15
I hapur ndërkombëtar në vlerë	7,600,500,301
I hapur lokal nr	1,835
I hapur lokal në vlerë	89,539,095,647
Kërkesë për propozim nr	3,106
Kërkesë për propozim vlerë	9,213,447,643
I kufizuar lokal nr	0
I kufizuar lokal vlerë	0
Negocim me shpallje	0
Negocim me shpallje vlerë	0

Nga analizimi i të dhënave dhe vlerave, rezulton se numri i procedurave të shpallura në vitin 2016 është më i lartë se në vitin 2015 (479 më shumë), ashtu sikurse edhe vlera totale e fondit limit të shpallur në këtë vit, e cila është konsiderueshëm më e lartë se sa ajo e vitit 2015 (17,528,359,364 lekë më shumë).

7.2.1.3. Statistika për njoftimet e fituesit

Numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2016 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **5067** (798 më shumë se në vitin 2015).

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik, të ndara sipas llojit të procedurës, dhe fondeve përkatëse, të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2016 janë si më poshtë:

Njoftime Fituesish Janar-Dhjetor 2015					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
E hapur Ndërkombëtare	30	E hapur Ndërkombëtare	17	E hapur Ndërkombëtare	
Procedurë e hapur lokale	469	Procedurë e hapur lokale	914	Procedurë e hapur lokale	566
Kërkesë për Propozim	769	Kërkesë për Propozim	1,715	Kërkesë për Propozim	474
Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	113	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi		Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	
Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale	
TOTALI	1,381	TOTALI	2,646	TOTALI	1,040

Ndërkohë, njoftimet e fituesit sipas llojit të procedurës dhe vlerave respektive, me të cilat janë shpallur dhe janë fituar procedurat paraqiten si më poshtë:

Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues
Janar-Dhjetor 2016

Llojet e procedurave	Nr.Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar	Fondi total i ofruar(tenderuar)	% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer	% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar
Procedurë e hapur ndërkombëtare (njoftim fituesi)	47	6,642,790,959	6,142,594,121	92.5	500,196,838	7.5
Procedurë e hapur lokal (njoftim fituesi)	1,949	79,905,147,689	73,287,151,586	91.8	6,610,731,812	8.2
Kërkesë për propozim (njoftim fituesi)	2,958	7,747,523,835	6,865,449,405	88.7	879,584,918	11.3
Shërbim konsulence, konkurs projektimi (njoftim fituesi)	113	1,147,519,856	1,076,752,880	93.9	70,766,976	6.1
I Kufizuar Lokal						
Totali	5,067	95,442,982,337	87,371,947,992	91.5	8,071,034,345	8.5

7.2.1.4. Statistika për kontratat e nënshkruara

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2016 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **4014** (1,736 më pak se në vitin 2015). Njoftimet e kontratave të nënshkruara sipas llojit të procedurave dhe tipit të kontratave paraqiten si më poshtë:

Njoftime Kontratash të nënshkruara Janar-Dhjetor 2016					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	116	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
E hapur Ndërkombëtare	28	E hapur Ndërkombëtare	93	E hapur Ndërkombëtare	
Procedurë e hapur lokale	312	Procedurë e hapur lokale	744	Procedurë e hapur lokale	522
Kërkesë për Propozim	608	Kërkesë për Propozim	1,169	Kërkesë për Propozim	422
Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale	
TOTALI	1,064	TOTALI	2,006	TOTALI	944

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave të shpallura në sistemin elektronik është **5,109**, ndërkohë që numri i procedurave të fituara (të cilat maten me njoftimet e fituesve të publikuara në sistem) është **5,067**. Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me faktin se disa nga procedurat e shpallura janë anuluar (për arsye të ndryshme të cilat do të analizohen më poshtë), ose janë procedura, të cilat janë shpallur në fund të vitit 2016 dhe nuk janë përfunduar ende me njoftimin e fituesit (janë në proces).

Gjithashtu, po nga tabelat më sipër rezulton se, numri i kontratave të nënshkruara (**4,014**) është më i vogël se numri i njoftimeve të kontratave fillestare (**5,109**) si dhe më i vogël se numri i fituesve (**5,067**). Kjo diferencë, përveç fakteve të përmendura më sipër shpjegohet edhe me faktin se për disa prej procedurave të shpallura ka pasur ankesa nga operatorët ekonomikë gjë që ka çuar në pezullimin e tyre deri në momentin e daljes së një vendimi përfundimtar nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe Gjykata Administrative.

7.2.1.5. Statistika mbi përqindjen e kursyer

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës, si dhe kursimin në %, të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2016.

Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin elektronik-Periudha Janar-Dhjetor 2016	
Nr.Total i procedurave të publikuara	5,109
Fondi total limit i procedurave të publikuara	108,230,737,689
Nr.Total i procedurave të cilat kanë vazhduar	4,616
Fondi total limit i proc.të cilat kanë vazhduar	102,004,643,554
Nr.Total i procedurave të papërfundura (anulluar,etj)	493
Fondi total limit i proc.të papërfundura (anulluar,etj)	6,226,094,135
Nr.Total i Proc.të fituara	5,067
Fondi total limit	95,442,982,337
Fondi total i prokuruar	87,371,947,992
% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	91.5%
Fondi total i kursyer	8,071,034,345
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	8.5%

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën më sipër, rezulton se nga 5,109 procedurat e shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, 493 prej tyre janë anuluar.

Për të kuptuar dhe analizuar drejt këtë shifër (e cila në pamje të parë është relativisht e lartë, po të kemi në konsideratë numrin total të procedurave të shpallura), duhet të kemi në konsideratë faktin që duke qenë se këto procedura zhvillohen në formë elektronike, ka dy arsye kryesore anulimi: i) arsye teknike; dhe ii) arsye ligjore.

Ndër arsyet teknike përmendim kryesisht gabimet në plotësimin/kryerjen e hapave në sistemin e prokurimit elektronik.

Ndër arsyet ligjore që çojnë në anulimin e procedurave përmendim vendimet e anulimit nga Komisioni i Prokurimit Publik, mungesë konkurrence gjatë zhvillimit të procedurave, anulimeve për shkak të mbylljes së vitit buxhetor, etj.

Një rast tjetër që vlen të përmendet në funksion të kësaj analize është dhe rasti kur shpallet një procedurë me lote dhe anulohen një ose disa lote të saj. Në këtë rast, numri i procedurës së shpallur është vetëm një, ndërkohë që për këtë procedurë të shpallur do të numërohen si procedura të anuluar çdo lot i mëvetshëm, nëse është rasti.

Gjithsesi, ajo që vlen të theksohet është se, numri i procedurave të anuluar gjatë vitit 2016 (493) është më i ulët se numri i procedurave të anuluar gjatë vitit 2015 (657). Kjo shifër mund të lexohet si një tregues i ngritjes së kapaciteteve të autoriteteve kontraktore, si në drejtim të punës në sistemin elektronik të prokurimit (duke minimizuar kështu anulimet për shkak të gabimeve teknike), ashtu edhe në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të procedurës në përputhje me legjislacionin në fuqi (duke ulur kështu numrin e procedurave të anuluar për shkak të problemeve ligjore të konstatuara në procedurë).

7.2.2. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit

Përveç procedurave të prokurimit publik të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, autoritetet kontraktore, nëse ndodhen në kushtet e parashikuara nga ligji, mund të kryejnë dhe procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake.

Të dhënat për procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake, për vitin 2016 paraqiten si më poshtë:

Periudha Janar-Dhjetor 2016 Kontratat me Procedurë Negocim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit	
Nr.Total i procedurave të fituara	2,186
Fondi total limit i prokuruar	8,155,169,113
Fondi total i ofruar pa tvsh	8,028,963,989
% që zë fondi total i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	98.5%
Fondi total i kursyer	126,205,124
% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar	1.5%

Nga tabela e mësipërme rezulton se, gjatë vitit 2016 janë zhvilluar gjithsej **2,186** procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duke shënuar një ulje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2015 me **520** procedura më pak.

Gjithsesi, pavarësisht uljes në krahasim me vitin 2015 kjo shifër vazhdon të mbetet e lartë dhe për këtë arsye, duhet të marrim parasysh të gjitha shkaqet apo situatat që çojnë në rritjen e numrit të këtyre lloj procedurave.

Për këtë, sikurse në vitin 2015, nga monitorimi i këtyre lloj procedurave është konstatuar se arsyet kryesore që çojnë autoritetet kontraktore në kryerjen e tyre vazhdojnë të jenë të njëjtat dhe konkretisht:

- Kryerja e procedurave me negociim pa shpallje, për një vlerë deri 20% të kontratës së fundit, për të përmbushur nevojat e fillim vitit, gjë që lejohet nga legjislacioni në fuqi.

- Parashikimet e legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor, sipas të cilave nuk lejohet fillimi i një procedure prokurimi nga ana e një autoriteti kontraktor në rast se, në llogarinë e këtij të fundit nuk ka kaluar buxheti përkatës. Verifikimi i këtij fakti bëhet nëpërmjet vulosjes së Urdhrit të Prokurimit në degën përkatëse të Zyrës së Thesarit, duke bërë kështu të pamundur për autoritetet kontraktore lidhjen e një kontrate nëpërmjet një procedure konkurruese prokurimi përpara muajit Mars (nga praktika ka rezultuar që kjo periudhë të shkojë deri në Prill ose Maj). Një situatë e tillë i vendos autoritetet në kushtet e një situatë emergjente sidomos kur bëhet fjalë për mallra dhe shërbime të domosdoshme si, ushqime, medikamente, pajisje mjekësore, shërbime pastrimi etj.
- Zgjatja e procedurave të prokurimit për shkak të vonesave të shkaktuara si pasojë e procesit të akimimit dhe mosrespektimit të afateve për vendimmarrje nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, fakt që përdoret si justifikim nga autoritetet kontraktore për zhvillimin e kësaj lloj procedure.
- Zgjatja në kohë dhe përfundimi me vonesë i procedurave të kryera nga Organi Qendror Blerës, gjë që le pa mbuluar nevojat e autoriteteve kontraktore për një grup mallrash apo shërbimesh që mbulohen nga blerja e përqendruar.

Sa më sipër, vërtetohet edhe nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mëposhtme ku evidentohet qartë që gati 2/3 e të gjithë procedurave me negociim pa shpallje paraprake të zhvillura gjatë vitit 2016 (1351 nga 2186), janë realizuar vetëm në periudhën Janar-Mars të vitit 2016.

Periudha Janar-Mars 2016-Kontratat me Procedurë Negocim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit	
Nr.Total i procedurave të fituara	1,351
Fondi total limit i prokuruar	3,302,507,641
Fondi total i ofruar pa tvsh	3,268,739,963
% që zë fondi total I ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	99%
Fondi total I kursyer	33,767,678
% që zë fondi I kursyer ndaj fondit limit të prokuruar	1%

Nga analizimi i të dhënave si më sipër rezulton se vetëm 835 procedura me negociim pa shpallje paraprake janë zhvilluar në periudhën Prill–Dhjetor të vitit 2016.

Konkretisht, numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të realizuar sipas muajve paraqitet si më poshtë:

Njoftime kontratash të nënshkuara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake			
	Nr i procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH
Janar	349	488,623,390	474,339,921
Shkurt	733	1,945,423,284	1,937,775,252
Mars	269	868,460,967	856,624,790
Prill	137	293,730,997	279,368,816
Maj	117	480,954,920	459,922,426
Qershor	69	350,956,615	347,955,073
Korrik	90	578,840,829	574,180,933
Gusht	89	543,614,690	535,956,901
Shtator	64	586,136,285	581,325,788
Tetor	52	373,939,709	371,799,769
Nëntor	72	488,324,942	472,897,625
Dhjetor	145	1,156,162,485	1,136,816,695
TOTALI	2186	8,155,169,113	8,028,963,989

Ndërkohë, ndryshimi i Dokumentave Standarde të Tenderit dhe konkretisht njoftimit të kontratës së nënshkuar, ku kërkohet që të evidentohen rastet e shtesave të kontratave duke bërë lidhjen me procedurën konkurruese me anë të së cilës është lidhur kontrata fillestare ka bërë të mundur që të identifikohet saktë numri i tyre për periudhën Prill-Dhjetor 2016 si më poshtë:

Njoftime shtesa kontratash të nënshkuara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake			
	Nr i procedurave	Nr i procedurave për shtesë kontrate	% që zenë shtesat e kontratave ndaj kontratave të nënshkuara me negociim pa shpallje
Prill	137	25	18%
Maj	117	10	8.5%

Qershor	69	8	11.6%
Korrik	90	14	15.6%
Gusht	89	21	23.6%
Shtator	64	14	22%
Tetor	52	12	23%
Nëntor	72	27	37.5%
Dhjetor	145	74	51%
TOTALI	835	205	25%

Siç tregohet edhe në tabelën e mësipërme rreth **25%** e procedurave negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të zhvilluara gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2016 kanë të bëjnë me shtesa kontratash dhe nuk janë procedura të reja por janë të lidhura me në procedurë konkurruese të zhvilluar më parë.

Në këtë kuptim, kemi të bëjmë me një rritje artificiale të numrit të rprocedurave negociim pa shpallje paraprake me **25%** për këtë periudhë. Gjithashtu, duhet pasur parasysh që, pavarësisht se për vitin 2016 nuk ka qenë e mundur identifikimi i saktë i numrit të shtesave të kontratave të nënshkruara me negociim pa shpallje paraprake për periudhën Janar-Mars 2016, siç rezulton edhe nga analiza e mësipërme shumica e procedurave negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të zhvilluara në këtë periudhë (në total 1351) kanë të bëjnë me shtesa kontratash sidomos ato për mbulimin e nevojave të fillim vitit.

Nisur nga analiza e mësipërme, sikurse është sugjeruar vazhdimisht nga APP, krijimi i situatave të emergjencave në autoritetet kontraktore mund të shmanget nëpërmjet marrjes së masave të mëposhtme:

- Heqja e pengesës së krijuar nga legjislacioni për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe sidomos Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit vjetor, sipas të cilit nuk lejohet zhvillimi i një procedure prokurimi pa u konfirmuar nga Drejtoria e Thesarit, gjendja e llogarisë së Autoritetit Kontraktor;
- Respektimi me rigorozitet nga të gjitha palët e përfshira në proces (autoriteti kontraktor, Organi Qendror Blerës, Komisioni i Prokurimit Publik) i afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik;

- Përdorimi i Marrëveshjes Kuadër, sidomos në rastet e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme dhe sidomos nga organet që shërbejnë si organe qendrore blerëse, qoftë Organi Qendror Blerës pranë Ministrisë së Brendshme, qoftë organet që përqendrojnë nevojat e organeve të varësisë.

Në këtë kuptim, nëse do të merren masat e sugjeruara në mënyrë të vazhdueshme, për të shmangur situatat kur autoritetet kontraktore janë të pambuluar me kontrata për nevojat e tyre, numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake do të minimizohet.

Në formë tabelore, të dhënat për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit si dhe raportet në % dhe fondi i kursyer në total, për vitin 2016, janë si më poshtë:

Prokurime elektronike dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit për Periudhën Janar-Dhjetor 2016	
Nr.Total i Procedurave të publikuara elektronike	5,109
Fondi total limit i procedurave të publikuara elektronike	108,230,737,689
Nr.Total i Procedurave të fituara elektronike	5,067
Fondi total limit i procedurave të fituara elektronike	95,442,982,337
Fondi total i prokuruar i procedurave të fituara elektronike	87,371,947,922
Nr.Total i Procedurave të fituara Negocim pa shpallje	2,186
Fondi total limit i prokuruar negociim pa shpallje	8,155,169,113
Fondi total i ofruar negociim pa shpallje	8,028,963,989
% që zë nr i procedurave të fituara negociim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	30.1%
% që zë fondi limit i procedurave me negociim pa shpallje ndaj fondit limit total (elektronik+negocim pa shpallje) për procedurat e fituara	7.9%
% që zë fondi i ofruar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj fondit total (elektronik+negocim pa shpallje) për procedurat e fituara	8.4%
Nr.Total i Procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	7,253
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	103,598,151,450
Fondi total i ofruar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	95,400,911,911

% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	92.1%
Fondi total i kursyer	8,197,239,539
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar	7.9%

Megjithë analizën e mësipërme dhe numrin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, vlen të theksohet fakti se, fondi limit i prokuruar me këtë lloj procedure **(8,155,169,113)** është shumë më i ulët, krahasuar me fondin total të prokuruar me procedurat e tjera konkurruese **(108,230,737,689)**.

7.2.3. Marrëveshjet Kuadër

Edhe gjatë këtij viti, nga analizimi i të dhënave rezulton se autoritetet kontraktore kanë vijuar të përdorin Marrëveshjen Kuadër duke u fokusuar kryesisht në prokurimin e shërbimeve si blerje e biletave të udhëtimeve, konsulencë, shërbime shëndetësore, apo riparime automjete e pajisje.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me përdorimin e këtij instrumenti, paraqiten si më poshtë:

Njoftime Kontratash për procedurat Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2016

Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2016		
Lloji i procedurës	Nr	Fondi Limit
I Hapur Lokal	20	789,995,838
Kërkesë për Propozim	23	101,566,916
Shërbim Konsulencë	3	166,666,667
Totali	46	1,058,229,421

Njoftime Fituesi për procedurat Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2016

Njoftime Fituesi për procedurat Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2016				
	Nr	Fondi Limit	Fondi i prokuruar	Diferenca e kursyer
I Hapur Lokal	18	750,881,838	698,453,420	52,428,418
Kërkesë për Propozim	21	91,431,569	91,431,569	0
Shërbim konsulencë	3	166,666,667	160,833,331	5,833,336
Totali	42	1,008,980,074	950,718,320	58,261,754

Njoftime Kontratash të Nënshkruara (Minikontratat) për procedurat Marrëveshje Kuadër

Marrëveshje Kuadër Minikontrata Janar-Dhjetor 2016		
	Nr	Vlera e kontratës
Totali	490	290,562,147

Pavarësisht se, nga të dhënat e mësipërme vërehet një rritje e numrit të Marrëveshjeve Kuadër të shpallura (**46 nga 34** në 2015) dhe të nënshkruara (**42 nga 24** në 2015) në krahasim me vitin 2015, ky instrument vazhdon të mbetet shumë pak i përdorshëm nga Autoritetet Kontraktore, në krahasim me numrin total të procedurave të tjera të zhvilluara në sistemin elektronik.

Sikurse kemi theksuar edhe me sipër, përdorimi i Marrëveshjes Kuadër nga Autoritetet Kontraktore do të ndikonte dukshëm në përmirësimin e sistemit të prokurimit në tërësi sidomos në drejtim të eliminimit të situatave emergjente dhe uljes së numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të zhvilluara për këtë qëllim.

7.2.4. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël vazhdojnë të zënë numrin më të madh të procedurave të zhvilluara në sistemin elektronik duke qenë se janë procedura të thjeshtuara në krahasim me llojet e tjera të procedurave konkurruese si në drejtim të kriterëve për kualifikim ashtu edhe në drejtim të afateve të reduktuara brenda të cilave zhvillohen.

Sa më sipër i bën ato lehtësisht të zbatueshme nga Autoriteti Kontraktor dhe lehtësisht të aksesueshme nga Operatorët Ekonomikë sidomos ata të biznesit të vogël dhe mesëm që janë edhe ofertuesit kryesorë në këto lloj procedurash.

Konkretisht, numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2016 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël Janar-Dhjetor 2016	
Nr Total i Blerje me Vlerë të Vogël	21,914
Fondi total limit i Blerje me Vlerë të Vogël	7,535,592,143
Fondi total i prokuruar i Blerje me Vlerë të Vogël	3,119,016,933
Nr.Total i Blerje me Vlerë të Vogël të cilat kanë vazhduar	17,010
Nr.Total i Proçedurave të papërfundura(anulluar,etj)	4,904
% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	41.4%
Fondi total i kursyer	4,416,575,211
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	58.6%

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme rezulton se në krahasim me vitin 2015 ku janë zhvilluar gjithsej **19 828** procedura prokurimi me vlerë të vogël, gjatë vitit 2016 ka pasur një rënie të numrit të tyre me **17 010** procedura gjithsej të përfunduara me njoftim fituesi. Ndërkohë, e njëjta tendencë vihet re edhe po të krahasojmë vlerat respektive prej nga rezulton se fondi i prokuruar me këtë lloj procedure gjatë vitit 2016 (**7,535,592,143**) është dukshëm më i vogël se fondi i prokuruar në vitin 2015 (**10,261,006,899**).

Nga ana tjetër, siç vërehet nga tabela, diferenca midis fondit, me të cilin janë shpallur procedurat, me fondin e prokuruar në përfundim të procedurave, është e konsiderueshme dhe

konkretisht **4,416,575,211** lekë, që përbën **58.6%** të fondit total të shpallur, duke shënuar rritje në kursim në krahasim me **56.5%** që ishte norma e kursimit në vitin 2015.

Kursimi i më shumë se gjysmës të fondit të shpallur për prokurim mund të shpjegohet duke pasur parasysh edhe rregullin, sipas të cilit, autoritetet kontraktore mund të përzgjedhin fituesin vetëm ndër 5 operatorët ekonomikë të klasifikuar të parët (pra 5 ofertat më të ulëta). Përcaktimi i këtij rregulli është bërë duke pasur parasysh numrin e lartë të ofertuesve në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për të shmangur zvarritjen e procedurës dhe shtyrjen e saj në kohë duke humbur kështu qëllimin kryesor të saj, zhvillimin në një kohë sa më të shkurtër.

Ndërkohë, nga tabela e mësipërme evidentohet edhe numri relativisht i lartë i procedurave të anulhuara nga autoritetet kontraktore, duke pasur parasysh që nga **21 914** procedura të shpallura, **4904** ose **22%** e tyre janë anuluar, numër ky që është më i madh, krahasuar me ato të anulhuara në vitin 2015 (**2607**).

7.2.5. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP gjatë vitit 2016

Numri i procedurave për dhënien me koncesion/PPP, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara, të dërguara gjatë vitit 2016, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Procedura për dhënien me koncesion /PPP	Numri i procedurave
Njoftime Kontratash	7
Njoftime Fituesish	5
Njoftime Kontratash të Nënshkruara	2

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, duhet theksuar se në këtë analizë paraqiten vetëm të dhënat që lidhen me procedurat e koncesionit që janë zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik dhe kontratat koncesionare të dërguara për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike.

Gjithashtu, në këtë analizë, duhet mbajtur në konsideratë fakti që njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të procedurave koncesionare/PPP, nuk i referohen vetëm procedurave të shpallura për t'u zhvilluar në 2016, por disa prej tyre janë njoftime që lidhen me procedura të shpallura që në vitin 2015.

Konkretisht, nga 5 njoftimet e fituesit të dërguar për publikim në vitin 2016, 3 prej tyre janë procedura të shpallura po në 2016, kurse 2 njoftime i referohen procedurave të shpallura në 2015. Po kështu, nga 7 njoftime të kontratave të shpallura, 2 prej tyre janë anuluar në vitin 2016.

7.2.6. Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2016

Gjatë vitit 2016 janë shpallur në Buletin e Njoftimeve Publike edhe procedura të ankandit publik, procedura këto të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore. Konkretisht, të dhënat në lidhje me këtë procedurë paraqiten si më poshtë:

Procedura të ankandit publik	Nr	Vlera e ofertuar
Njoftime Fituesish	147	7,058,911,863
Njoftime Kontratash të Nënshkruara	39	6,827,479,165
Njoftime Anullimi	172	

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë që këto njoftime janë dërguar për publikim në vitin 2016, por një pjesë e tyre lidhen me procedura të shpallura për t'u zhvilluar që në vitin 2015.

Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:

Njoftime Fituesish për Ankandet Janar- Dhjetor 2016

Muaji	Nr i Procedurave	Vlera e Ofertuar
Janar	9	95,845,531
Shkurt	13	602,406,897
Mars	12	37,351,151
Prill	7	3,255,668
Maj	15	8,053,013
Qeshor	9	15,202,526
Korrik	8	17,344,702
Gusht	10	13,890,240
Shtator	7	3,168,091
Tetor	19	18,769,621
Nentor	15	49,118,909
Dhjetor	23	6,194,449,156
Totali	147	7,058,855,505

Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet Janar-Dhjetor 2016

Muaji	Nr i Procedurave	Vlera e Ofertuar
Janar	1	45,000
Shkurt	2	79,248,595
Mars	1	540,000,000
Prill	5	25,004,808
Maj	4	5,749,055
Qeshor	3	4,063,320
Korrik	0	-
Gusht	3	919,984
Shtator	2	11,971,778
Tetor	4	2,985,830
Nentor	4	10,051,476
Dhjetor	10	6,147,439,319
Totali	39	6,827,479,165

7.3. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2016, në bashkëpunim Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit është bërë instalimi dhe konfigurimi i agentit të Audit Vault si dhe në serverat e databazës, duke mundësuar kështu monitorimin e plotë të sistemit me Audit Vault.

Me një rëndësi të vecantë mund të konsiderohet nënshkrimi me sukses i kontratës me objekt “Ri-inxhinierim dhe shtim i funksionaliteteve/shërbimeve në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re”, me anë të së cilës, është realizuar infrastrukturë hardware e re, si dhe është në përfundim të implementimit përmirësimi dhe shtimi i disa funksionaliteteve të reja për Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Konkretisht, nëpërmjet këtij procesi synohet të realizohet:

- Ri-inxhinierimi i strukturës së të dhënave dhe ngritjen e platformës aktuale të sistemit (framework) në versionet më të reja me qëllim rritjen e performancës së Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe shmangien sa më shumë të incidenteve që vijnë për shkak të saj;
- Automatizimi i Regjistrave të Parashikimeve dhe Realizimeve me qëllim lehtësimin e punës për autoritetet kontraktore, duke u dhënë atyre mundësinë e hedhjes automatike të të dhënave pa qenë e nevojshme dërgimi i tyre në rrugë shkresore dhe CD në APP;
- Shtimi i shërbimeve elektronike në platformën e-Albania për rritjen e transparencës dhe notifikimin e përdoruesve (publikë/operatorë ekonomikë) për llojet e tenderave që publikohen;
- Mundësimi i ofertimit nëpërmjet aplikacioneve mobile për platformat kryesore iOS dhe Android për procedurat me blerje të vogël;
- Shtimi i funksionaliteteve që mungojnë dhe pengojnë ecurinë normale të punës dhe që aktualisht zgjidhen duke raportuar incidente;
- Krijimi i një sistemi dhe infrastrukture arkivimi për procedurat e përfunduara;
- Krijimi i një sistemi “Business Intelligence” për raportime dhe analiza komplekse;
- Krijimi i një infrastrukture testimi, e cila aktualisht mungon, për të krijuar kushtet për punë metodike gjatë ndërhyrjeve apo zhvillimeve;
- Krijimi i një infrastrukture për “Business Continuity” në mjediset e APP, ndërkohë që Production duhet të vendoset në mjediset e AKSHI-t etj

Gjithashtu, Sektori i Teknologjisë së Informacionit edhe pse deri në 6 mujin e dytë të vitit 2016 ka qenë me numër të reduktuar të specialistëve të IT, ka punuar maksimalisht në ofrimin

e shërbimeve me siguri të lartë për të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit, si dhe çdo Autoritet tjetër që, në përmbushje të detyrave të tij, përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Detyrat kryesore që ka përmbushur ky sektor për vitin 2016 kanë qenë si më poshtë:

- Garantimi në kohë dhe me cilësi i ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE).
- Zgjidhja e problematikave të ndryshme hardware dhe software, gjatë punës së përditshme duke garantuar ecurinë normale të prokurimit elektronik.
- Rritja e kapaciteteve për Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemin e Arkivës Elektronike (SAE). Përmirësimi i vazhdueshëm dhe optimizimi i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve.
- Garantimi i siguri fizike të SPE dhe SAE në ambientet e caktuara. Në këtë kuptim, të gjitha asetet e informacionit të APP duhet të mbrohen në shkallën më të lartë nga dëmtimet fizike. Rrjeti informatik u nënshtrohet rregullave për sigurimin fizik të informacionit, të përcaktuara në Planin e Sigurisë së rishikuar.
- Garantimi i Konfidencialitetit të ofertës ekonomike duke bërë enkriptimin dhe dekriptimin çka ka bërë që Informacioni me ndjeshmëri të lartë të jetë i përdorshëm vetëm për ata persona që janë të autorizuar ta shohin ose ta përdorin atë.
- Pasurimi i portalit të APP, me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit, nëpërmjet publikimit të 52 buletinëve javorë, publikimit të legjislacionit të përditësuar, vendimeve, udhëzimeve, raporteve, moduleve të trajnimit, monitorimeve, regjistrave të parashikimeve, realizimeve etj, në total 55 dokumenta, publikimi i 16 njoftimeve të ndryshme të aspektit teknik, në lidhje me funksionimin e sistemit, publikimi i Dokumentave Standarte të Tenderit të reja, në total 39 dokumenta.
- Sigurimi i back-up ditor, javor dhe mujor i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE), si dhe ruajtja tek AKSHI.
- Garantimi i asistencës teknike për çdo kërkesë (kërkesat për dekriptim dokumentash, kërkesat për zëvendësim të anëtarëve të KVO, kërkesat për sqarim, ankesat nga ana teknike), të mbërritura në APP.
- Monitorimi i kontratës së mirëmbajtjes për Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemin e Arkivës Elektronike (SAE).
- Garantimi i asistencës teknike për telefonatat dhe e-mailet e mbërritura në APP.
- Hartimi i specifikimeve teknike për kontratat që APP do të lidhë me të tretët.

- Krijimi, azhornimi si dhe mbyllja e llogarive të administratorit për Autoritetet Kontraktore. Për vitin 2016 janë shtuar 37 Autoritete Kontraktore të reja që përdorin

Sistemin e Prokurimit Elektronik. Ky numër ka shkuar në 2664 Autoritete Kontraktore me llogari aktive.

- Krijimi, azhurnimi si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Autoritetet Kontraktore si dhe Audituesit.
- Krijimi, azhurnimi si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Operatorët Ekonomikë.
- Monitorimi i procedurave të prokurimit të lëna pezull në sistem dhe tërheqja e vëmendjes ndaj personave përgjegjës konform legjislacionit në fuqi.
- Monitorimi i sistemit të back up në tape në mënyrë që të rritet siguria e ruatjes së të dhënave si dhe hartimi dhe zbatimi me përpikmëri i protokollit të ruatjes së tape-ve.
- Pasqyrimi i përjashtimeve të operatorëve ekonomikë në portalin e APP.
- Arkivimi i të gjitha procedurave të lëna pezull nga Autoritetet Kontraktore. Ky proces bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të dhe, për pasojë, duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
- Garantimi i asistencës teknike për llogari audituese për çdo auditues të Autoriteteve Kontraktore si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Zbatimi i detyrimeve në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare.
- Garantimi i trajnimeve për institucionet qendore dhe vendore në fushën e prokurimit publik në fushën e IT.

Sektori i Teknologjisë së Informacionit është përpjekur maksimalisht, për të mbajtur “online” Sistemin e Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës, përveç rasteve kur nxjerrja e tij “offline” për një periudhë shumë të kufizuar, ka qenë e nevojshme për kryerjen e shërbimeve përkatësen dhe paralajmërohet me anë të një njoftimi, pa cenuar në asnjë moment afatet e procedurave të prokurimit.

Qëndrimi në gatishmëri, jashtë orarit zyrtar të punës, gjatë fundjavës, si dhe ditëve të cilat janë festa zyrtare i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, duke monitoruar ecurinë e punës në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës kanë qenë në total rreth 2400 orë për vitin 2016.

Rezultati i punës së Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit ka qenë administrimi i sigurt i një totali baze të dhënash prej:


- i. 1077 GB (1,077,337,918,976 bytes) të Sistemit të Prokurimit Elektronik, dhe
- ii. 11.21 TB (11,211,277,434,880 bytes) të Sistemit të Arkivës Elektronike.

Tabela e kapaciteteve të bazës së të dhënave sipas viteve:

	Viti 2014	VITI 2015	VITI 2016
Sistemi i Prokurimit Elektronik (në bytes)	602,749,889,024	767,777,769,984	1,077,337,918,976
Arkiva Elektronike (në bytes)	7,234,786,510,766	8,718,846,291,456	11,211,277,434,880
Totali (në bytes)	7,837,536,399,790	9,486,624,061,440	12,288,615,353,856
Totali (në Terabyte)	7.8375364	9.486624061	12.288615353

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet paraqitet kapaciteti i bazës së të dhënave për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike në TB.

Grafiku i kapacitetit të bazës së të dhënave për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike në TB



7.3.1. Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP

Mbështetja teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore, si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-eve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i telefonatave të marra nga drejtorja ka qenë rreth **60** telefonata në ditë.

Gjatë vitit 2016, nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit:

Janë përgatitur **2100** shkresa në total, ku përfshihen:

- Krijim/ Mbyllje llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare;
- Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë;
- Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera;
- Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe të Monitorimit në APP;

Janë dërguar **2500** e-maile në total, drejt:

- operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa);
- autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
- institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Dhënia e asistencës teknike nga ky sektor është bërë edhe nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të organizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Shkolla e Administratës Publike, ku specialistë të IT, kanë mbuluar sesionet mbi përdorimin e Sistemit Elektronik të prokurimeve.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së IT-së me Drejtorinë Juridike dhe të Monitorimit ka qenë shumë produktiv edhe për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre, si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

7.3.2. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2016

Për vitin 2016 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar **6435** përdorues të rinj, dhe përkatësisht:


- Nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2016 janë krijuar **37** llogari të reja në rolin “Administrator” për Autoritetet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit

Elektronik. Numri total i Autoriteteve Kontraktore që përdorin Sistemin e Prokurimit Elektronik shkon në **2664**.

- Nga llogaritë e Administratorëve të Autoritete Kontraktore janë krijuar **6,398** përdorues si në tabelën më poshtë:

Përdoruesit e Autoriteteve Kontraktore të regjistruar për vitin 2015													
	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Totali
Nr	436	850	863	664	450	459	439	363	481	452	519	422	6,398


Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitin 2016. Nga figura shihet qartë numri më i madh i përdoruesve është krijuar në muajt Shkurt dhe Mars, e cila është dhe periodha kur është e përqendruar shpallja e procedurave të reja.



Për vitin 2016, në sistemin e prokurimit elektronik në rolin e operatorëve ekonomikë janë regjistruar **1965** operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët **91** janë operatorë ekonomikë të huaj.

Operatorët Ekonomikë të Regjistruar në vitin 2016	
Operatorët Lokalë	1874
Operatorët Ekonomikë të Huaj	91
Totali	1965

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i Operatorëve Ekonomikë të rinj të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të krijuar përkatësisht në vitet, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016. Këtu vihet re qartë numri në rritje të përdoruesve të krijuar në vitin 2016, krahasuar me vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Kjo rritje shpjegohet me interesimin gjithmonë e më të madh të Operatorëve Ekonomikë për të marrë pjesë në prokurimet publike.



Një nga detyrat e përditshme të Sektorit të IT-së konsiston edhe në suportin e përdoruesve brenda APP, si dhe në menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit të brendshëm kompjuterik dhe telefonik.


7.3.3. Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik

Numri total i aplikimeve të krijuara nga Njësitë e Prokurimit/Komisionet e Prokurimit me Vlerë të Vogël pranë Autoriteteve Kontraktore për vitin 2016 në Sistemin e Prokurimit Elektronik është **27023**. Nga këto:

- **21914** janë aplikime për prokurime me Vlerë të Vogël;
- **5109** janë aplikime për Procedura Konsulence, Konkurs Projektimi, Procedura me Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit, Procedura të Hapura, Kërkesë për Propozim, etj.

Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave mbi vlerën 800.000 lekë, ku, sikurse dhe nga treguesit e analizuar më sipër, del qartë volumi më i madh që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.

Raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave mbi vlerën 800.000 lekë



Megjithatë, pavarësisht se në raportin në numër dominojnë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, duhet theksuar se në raportin në vlerë, dukshëm dominojnë procedurat e prokurimit mbi vlerën 800.000, duke qenë se raporti është në të kundërt; fondi i prokuruar me procedurë prokurimi me vlerë të vogël zë rreth 3.4%, kurse fondi i prokuruar me procedura të tjera zë rreth 96.6%.

7.3.4. Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik për procedurat e arkivuara

Numri total i ofertave të krijuara dorëzuara nga operatorët ekonomikë pranë procedurave të publikuara nga Autoriteteve Kontraktore për vitin 2016 në Sistemin e Prokurimit Elektronik është 499527. Nga këto:

- 479959 janë oferta të dorëzuara në prokurime me Vlerë të Vogël;
- 19568 janë oferta të dorëzuara në Procedura Konsulence, Konkurs Projektimi, Procedura me Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit, Procedura të Hapura, Kërkesë për Propozim, etj.


Në tabelën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të oferta të dorëzuara në prokurimet me vlerë të vogël, ndaj numrit të oferta të dorëzuara në procedurave mbi vlerën 800.000 lekë, konkretisht:

Informacion mbi Ofertat Elektronike per vitin 2016	
Nr i Procedurave/ Loteve	4630
Nr Total i Ofertave për Procedurat e Prokurimit	19568
Mesatarja e Ofertave për Procedurat e Prokurimit	4
Nr i Prokurimeve me Vlerë të Vogël	21914
Nr total i Ofertave për Prokurimet me Vlerë të Vogël	479959
Mesatarja e Ofertave për Prokurimet me Vlerë të Vogël	22

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja e ofertave në prokurimet me vlerë mbi 800.000 lekë është rreth 4 oferta për procedurë, kurse në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël kjo mesatare shkon rreth 22 oferta për procedurë duke shënuar rritje nga viti 2015 ku kjo mesatare ka qenë 14 oferta për procedurë.

Rritja e numrit mesatar të ofertave për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël është një tregues shumë i rëndësishëm sa i takon rritjes së interesit të operatorëve ekonomikë, sidomos bizneseve të vogla dhe të mesme për të ofertuar si edhe rritjes së besueshmërisë së tyre për përdorimin e sistemit elektronik dhe njëkohësisht rritjes së kapaciteteve të tyre në këtë drejtim.

Grafiku i mëposhtëm tregon raportin e numrit të ofertave të prokurimeve nr vlerë të vogël ndaj ofertave në procedurat mbi 800,000 lekë:




7.3.5. Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik

7.3.5.1. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për vitin 2016 në total kemi **228,314,227** klikime:

Klikimet Total	228,314,227
Klikimet sipas Vizitor	227,683,175
Mesatarja Klikimet ne dite	622,109
Mesatarja Klikimet per Vizitor	149
Shikimet e faqes	
Shikimet e faqes Total	106,594,676
Mesatarja e Shikimeve te faqes ne dite	290,448
Mesatarja e Shikimeve te faqes per Visitor	70
Total Visitors	1,527,893
Mesatarja Visitors per Day	4,163
Total Unique IPs	101,724




7.3.5.2. Aktiviteti i përdorueve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas 24 orëve.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve:

00:00-0:59	799,881	410,714	9,617
01:00-01:59	388,319	206,446	6,926
02:00-02:59	242,286	137,298	4,486
03:00-03:59	222,739	132,897	4,442
04:00-04:59	279,334	168,458	4,998
05:00-05:59	609,812	343,294	8,144
06:00-06:59	1,825,260	839,700	21,049
07:00-07:59	10,989,462	4,726,729	92,916

08:00-08:59	20,498,629	8,947,408	140,346
09:00-09:59	23,754,663	10,680,514	140,537
10:00-10:59	23,484,600	10,866,563	132,977
11:00-11:59	22,195,698	10,567,747	129,204
12:00-12:59	21,609,657	10,388,879	127,722
13:00-13:59	21,099,770	10,202,469	123,007
14:00-14:59	20,071,270	9,644,753	116,043
15:00-15:59	15,570,824	7,473,133	95,791
16:00-16:59	10,116,372	4,837,277	73,218
17:00-17:59	7,461,327	3,529,092	60,273
18:00-18:59	6,449,087	2,953,536	53,795
19:00-19:59	5,894,069	2,652,214	50,802
20:00-20:59	5,247,489	2,356,516	46,217
21:00-21:59	4,383,100	2,033,961	39,090
22:00-22:59	3,293,869	1,592,238	29,204
23:00-23:59	1,826,710	902,840	17,089
Total	228,314,227	106,594,676	1,527,893




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë orarit 8:00-17:00.

7.3.5.3. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas ditëve të javës.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas ditëve të javës:

E Hene	41,817,403	18,993,812	272,452
E Marte	42,549,287	19,813,582	272,190
E Merkture	43,562,960	20,590,167	275,085
E Enjte	44,212,606	20,881,789	275,736
E Premte	38,440,403	18,517,223	250,166
E Shtune	11,147,281	4,889,352	112,119
E Diel	6,584,287	4,889,352	112,119
Total	228,314,227	106,594,676	1,527,893




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është javës është nga e Hëna në të Premte.

7.3.5.4. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas muajve të vitit.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas muajve:

Muaj	Klikimet	Shikimet e faqes	Vizitors
Janar 2016	11,620,915	4,705,023	101,173
Shkurt 2016	17,719,377	7,883,577	119,681
Mars 2016	21,624,960	9,812,463	134,307
Prill 2016	22,825,347	10,521,019	139,375
Maj 2016	22,161,837	10,217,051	141,588
Qershor 2016	20,298,069	9,421,056	131,491
Korrik 2016	17,116,092	7,934,204	116,499
Gusht 2016	16,516,579	7,773,159	117,217
Shtator 2016	17,967,019	8,332,491	124,732
Tetor 2016	20,115,347	9,590,510	133,185
Nentor 2016	20,561,856	10,311,436	135,967
Dhjetor 2016	19,597,067	10,09,99	131,120
Total	228,314,227	106,594,676	1,527,893




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është nga Muaji Shkurt deri në muajin Qershor.

7.3.5.5. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas qyteteve kryesore.

Gjithashtu, nga analizimi i të dhënave nga tabela del grafiku i mëposhtëm, që tregon aktivitetin e përdoruesve sipas Qyteteve:

1	Tirana, Albania	93,485,270	569,179
2	Durrës, Albania	4,039,971	21,055
3	Elbasan, Albania	2,826,224	20,901
4	Vlorë, Albania	3,566,952	19,010
5	Fier, Albania	1,624,096	8,164
6	Shkodër, Albania	1,523,637	6,351
7	Bajram Curri, Albania	677,062	2,889
8	Berat, Albania	408,023	2,805
9	Gjirokatër, Albania	244,186	1,704
10	Te tjera	5,409,656	103,521
	Totali	113,805,077	755,579

Aktiviteti i përdoruesve sipas Qyteteve



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, përdoruesit kryesore të Sistemit të Prokurimit Elektronik janë nga qytetet kryesore.


7.3.5.6. Aktiviteti i përdoruesve sipas klikimeve, shikimeve dhe vizitorëve sipas shteteve.

Gjithashtu, nga analizimi i të dhënave nga tabela del grafiku i mëposhtëm, që tregon aktivitetin e përdoruesve sipas shteteve:

1	Albania	192,136,593	1,180,252	77.25%
2	Itali	30,510,304	218,953	14.33%
3	Austria	622,153	36,870	2.41%
4	Greece	366,654	4,811	0.31%
5	Germany	619,280	10,466	0.68%
6	Macedonia	679,265	10,238	0.67%
7	UK	109,553	4,850	0.32%

8	Serbi	91,030	2,041	0.13%
9	Turqi	65,494	12,857	0.91%
10	Te tjera	2,482,837	46,555	3.12%
	Totali	227,683,163	1,527,893	100%


Aktiviteti Javor sipas Shteteve




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, interesi kryesor për pjesëmarrjen në prokurimet publike në republikën e Shqipërisë vjen nga operatorët ekonomikë të shteteve fqinje kryesisht nga Italia.

7.3.5.7. Aksesimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve dhe sistemeve operative.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin e Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve të kërkimit:





1	Internet Explorer	120,379,651	707,783	37.49%
2	Google Chrome	70,116,398	664,823	35.21%
3	Firefox	29,044,940	234,783	12.44%
4	Shockwave Flash	718,738	89,146	4.72%
5	Mobile Safari	1,855,759	64,265	3.40%
6	Microsoft Edge	3,268,933	30,832	1.63%
7	Opera	804,794	11,170	0.59%
8	MobileSafari/602.1/CFNetwork/808.0.2/Darwin/16.0.0	98,880	9,997	0.53%
9	Safari	560,155	8,087	0.43%
10	Others	41,566	7,870	0.42%



Shfletuesit më të përdorur


Grafiku i mëposhtëm pasqyron versionet e Internet Explorer and Microsoft Edge që përdoren për aksesimin Sistemit e Prokurimit Elektronik nga përdoruesit:



Me përfundimin e implementimit të kontratës për përmirësimi dhe shtimin e disa funksionalitetve të reja për Sistemin e Prokurimit Elektronik, do të bëhet e mundur aksesimi

dhe funksionimi normal i të gjithave ndërfaqeve të sistemit nga të gjitha llojet e shfletueve si Google Chrome, Mozilla Firefox, etj

Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas sistemeve operative të përdorura nga përdoruesit:




8. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, INTEGRIMIT DHE FINANCËS

8.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

APP edhe përgjatë vitit 2016 e ka ushtruar aktivitetin e saj ligjor me 2 (dy) drejtori dhe 1 (një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, përkatësisht: (i) Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit me 2 (dy) sektorë (Sektori i Monitorimit dhe Sektori Juridik); (ii) Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit me 2 (dy) sektorë (Sektori i Publikimit dhe Sektori Teknologjisë së Informacionit) si dhe (iii) Sektorin e Integrimit, Burimeve Njerëzore dhe Financës.

Me Urdhrin Nr. 23, datë 10.02.2016 të Kryeministrit “Për një ndryshim në urdhërin Nr. 13, datë 11.02.2015 ‘Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik’, me përfshirjen në strukturë të punonjësve të pastrimit, numri total i punonjësve në institucion është 29 (njëzet e nëntë), sipas organigramës së mëposhtme:



Gjatë vitit 2016 janë evidentuar zhvillimet e mëposhtme deri në plotësimin e të gjitha vendeve sipas strukturës:

- Janë larguar me dorëheqje 2 (dy) punonjës, konkretisht, 1 (një) specialist në Sektorin e Publikimit, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit dhe 1 (një) punonjës administrativ (shofer).
- Është larguar me ngritje në detyrë 1(një) Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Monitorimit.
- Bazuar në pozicionet vakante të miratuara me Urdhërin Nr. 11, datë 13.11.2015, vendet vakante për shkak të largimeve, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të legjislacionit të shërbimit civil apo Kodit të Punës, u krye procesi i rekrutimit dhe emërimit për pozicionet:
 - 1 (një) Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit;
 - 1 (një) specialist në Sektorin e Monitorimit, në Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit;
 - 1(një) specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit;
 - 1 (një) specialist në Sektorin Juridik, në Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit;
 - 1 (një) punonjësi administrativ (shofer);
- Është kryer ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë për emërimin dhe sistemimin e 1(një) nëpunësi civil, përkatësisht në pozicionin Specialist në Sektorin e Publikimit, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për punonjësit me kontratë, APP ka kontraktuar me kontratë shërbimi 1 (një) punonjës arkivi.

8.2. AUTORITETI PËRGJEGJËS

Autoriteti Përgjegjës në institucion, ka mbajtur në mënyrë të rregullt kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarimin e pasurive në institucion, si dhe ka dërguar në kohë deklaratimet përkatëse.

Gjatë këtij viti, APP në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, ka depozituar në kohë Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor dhe Deklarimin e Interesave Para Fillimit të Detyrë, sipas legjislacionit në fuqi.

8.3. AKTIVITETET NË DREJTIM TË FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË STAFIT TË APP DHE SPECIALISTËVE TË PROKURIMIT PUBLIK PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE

8.3.1. Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

Gjatë vitit 2016 përfaqësues të APP kanë marrë pjesë në një sërë takimesh dhe seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

Në datat 18-23 Janar 2016, APP ishte pjesë e vizitës studimore që u organizua në Vienë, Austri, me objekt “Implementimi i një Sistemi Modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MKF) dhe Inspektimi Financiar Publik në Shqipëri”, përfaqësuar nga niveli i lartë institucional.

Në datat 17-19 Maj 2016, në forumin e 12-të të Prokurimit, Integritetit, Menaxhimit dhe Transparencës (PRIMO) me temë “Profesionalizimi i prokurimit publik”, mbajtur në Astana, Kazakistan, APP u përfaqësua nga 3 (tre) punonjës të saj.

Në datat 01-04 Nëntor 2016, me ftesë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, APP u bë pjesë e kursit rajonal për prokurimin publik organizuar në Vienë nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), me në fokus vlerësimin e antarësimit të Shqipërisë në OBT.

Në takimin e 5-të të grupit të punës për prokurimin publik, me objekt “Tendencat e prokurimit publik dhe praktikat e reja” të organizuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) në datat 14-15 Dhjetor, APP mori pjesë me 2 (dy) përfaqësues të saj.

Në forumin për prokurimin elektronik, mbajtur në Berlin, Gjermani, në datat 13-15 Dhjetor 2016, me fokus shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave në fushën e prokurimit elektronik nga vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore, APP u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit.

Gjithashtu, APP ka qenë pjesë e takimit të 5-të të grupit të punës mbi prokurimin publik, fokus i të cilit ishte zhvillimin i trendeve në prokurimit publik dhe njohjen me praktikat e reja, që u zhvillua në data 14-15 Dhjetor 2016 në Beograd, Serbi.

8.3.2. Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore

APP, me qëllim njohjen e punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik në Autoritetet Kontraktore të pushtetit qendror dhe vendor, ka organizuar disa seanca trajnimi në fushën e prokurimit publik.

Edhe përgjatë vitit 2016, APP ka vijuar bashkëpunimin me Shkollën e Administratës Publike (ASPA), në hartimin e kurrikulave të trajnimit, si dhe në zhvillimin e trajnimeve në fushën e prokurimit publik.

APP në bashkëpunim me ASPA kanë hartuar kurrikulën e trajnimit në fushën e prokurimit, e cila u aplikua në 7(shtatë) trajnime 9 (nëntë) ditore, duke trajtuar prokurimin publik me të gjithë komponentët e tij.

Gjithashtu, APP në përmbushje të detyrimit ligjor për trajnimin në fushën e prokurimit edhe të punonjësve të njësisë vendore, ka zhvilluar 9 (nëntë) seanca trajnimi 1-ditore, për 61 (gjashtëdhjetë e një) bashkitë e vendit, duke e çuar numrin e të trajnuarve në 85 (tetëdhjetë e pesë).

Tabela e mëposhtme tregon numrin e të trajnuarve në total për vitin 2016, sipas llojit të trajnimit:

Nr.	Insitucioni organizues	Kohëzgjatja	Numri i trajnimeve	Numri i të Trajnuarve
1	APP + ASPA	9 (nëntë) ditore	7(shtatë)	152
2	APP	1 (një) ditore	9 (nëntë)	85
TOTALI	237 nëpunës			

8.4. INTEGRIMI EUROPIAN

APP ka vijuar raportimin periodik pranë Ministrisë së Integrimit Evropian dhe Strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, në kuadër të procesit të Integrimit Evropian dhe detyrimeve që ky proces shoqëron përsa i përket fushës së prokurimit publik.

Në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Integrimit Evropian, APP në cilësinë e institucionit koordinues për Kapitullin 5: Prokurimi Publik ka organizuar takime të përmuajshme të Grupit Ndërinstitucional të Punës për këtë kapitull, me qëllim diskutimin e rekomandimeve të dhëna në Komisioni Evropian në raportin e tij për Shqipërinë në vitin 2015 dhe masat që duhet të merren për adresimin e tyre.

Një fokus të veçantë në këtë takime kanë zënë diskutimet mbi transpozimin e direktivës 2009/81 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe hartimin e një projektligji të veçantë për këtë qëllim. Në këtë kuadër, është ngritur një grup ndërinstitucional pune, i cili ka përgatitur një draft fillestar që pritet të diskutohet më tej dhe të finalizohet.

Në datë 26 Maj 2016 u zhvillua në Tiranë takimi i shtatë i Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit”, gjatë të cilit APP raportoi në mënyrë të detajuar mbi progresin e arritur, në drejtim të përafrimit të legjislacionit në këtë fushë, në bazë të pyetjeve specifike të dërguara nga Komisioni Evropian.

Në datë 09 Qershor 2016 u zhvillua në Tiranë takimi i rradhës i Komitetit të Stabilizim Asociimit, ku APP raportoi mbi progresin e arritur, në këtë fushë, për periudhën e kërkuar, kryesisht në drejtim të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimit të tij, si dhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve të institucioneve të përfshirë në rregullimin dhe zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik.

Gjithashtu, në kuadër të raportimit, është përgatitur në nivel kapitulli kontributi për raportin e vitit 2016 të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.

Në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), 2017-2020 nga Ministria e Integrimit dhe përcaktimit të prioriteve përkatëse sipas kapitujve, APP ka përgatitur materialin për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, duke përcaktuar prioritetet dhe masat legjislative afatshkurtra dhe afatmesme për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë.

Gjithashtu, në kuadër të implementimit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike pjesë e të cilës është edhe Prokurimi Publik, APP ka punuar për implementimin e masave të përcaktuara për këtë Strategji dhe raportimin në kuadër të monitorimit të saj si dhe ka bashkëpunuar ngushtësisht me ekspertët e SIGMA në kuadër të përgatitjes së pasaportës së indikatorëve për monitorimin e kësaj Strategjie.

Po kështu, APP ka raportuar edhe në lidhje me zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit si edhe ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e zhvilluara për këtë qëllim. Në këtë kuadër, APP është përfshirë edhe në diskutimet e zhvilluara me Delegacionin e Bashkimit Europian për nënshkrimin e marrëveshjes financiare për mbështetje buxhetore për implementimin e kësaj strategjie.

Një tjetër Strategji e rëndësishme, pjesë e të cilës është edhe prokurimi publik është Strategjia për Reformën në Administratën Publike, ku është raportuar lidhur me implementimin e masave në kuadër të kësaj strategjie.

8.5. GJENDJA FINANCIARE E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2016

Mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, si edhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2016, dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të institucionit Agjencia Prokurimit Publik, për periudhën Janar - Dhjetor 2016, paraqitet si vijon:

Në lekë

	Emërtimi	Plan vjetor 2016	Plani i rishikuar	Fakt 12 mujor	Në %
1	Shpenzime paga	27,000,000	22,800,000	22,451,821	98%
2	Sigurime Shoqërore	4,100,000	4,100,000	3,629,418	89%
3	Mallra Shërbime	19,200,000	19,200,000	19,151,050	99.7%
4	Shpenzime për investime	6,000,000	500,000	413,520	82.7%
	Totali i shpenzimeve	53,300,000	46,600,000	45,645,809	98%
5	Fonde nga FZHR	161,436,850	161,436,850	18,929,700	12%

Shpenzimet e përgjithshme, duke u bazuar në buxhetin e vitit 2016 në fund të vitit 2016, kanë arritur në 45,645,809 lekë, nga 46,600,000 lekë që është buxheti i rishikuar për vitin 2016, duke u realizuar në masën 98% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 954,000 lekë.

Shpenzimet korente në fund të vitit 2016, kanë arritur në shumën rreth 45,227,000 lekë ose rreth 98% e buxhetit të rishikuar, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 873,000 lekë.

Konkretisht përqindja e shpenzimeve sipas zërave paraqitet si më poshtë:

	Struktura në %	Buxheti 2016
1	Paga	49
2	Sigurime Shoqërore	8
3	Mallra Shërbime	42
4	Shpenzime kapitale	9
	Totali i shpenzimeve	45 646

Shpenzimet në fondet e buxhetit në zërin “paga dhe sigurime shoqërore” rezultojnë me mospërdorim të fondit prej 348,000 lekë. Me buxhetin e rishikuar, sipas Aktit Normativ Nr. 2 datë 16.12.2016, shpenzimet për paga u pakësuan me 4,200,000 lekë, si pasojë e mos plotësimit që nga fillimi i vitit të vendeve vakante të numrit të punonjësve të planifikuar.

Sa i takon zërit “shpenzime për mallra e shërbime”, gjatë vitit 2016, rezulton me një realizim vjetor prej 19,151,050 lekë nga 19,200,000 lekë i planifikuar, pra i realizuar 99.7%, duke shlyer edhe pjesën më të madhe të detyrimit për shpenzime gjyqësore të mbartura nga viti 2015.

Ndërkohë, shpenzimet kapitale deri në fund të vitit 2016, janë realizuar në masën 413,520 lekë ose rreth 82.7% e planit të rishikuar, duke pakësuar planin me 5,500,000 lekë, për arsye se pajisjet e planifikuara për sistemin elektronik u realizuan në zërin “Infrastrukturë e re dhe ri-inxhinierim i arkitekturës hardware” në shumën 18,929,700 lekë me fondet e investimeve të akorduara nga Fondi i Zhvillimit Rajonal për programin “Shqipëria Dixhitale” për projektet “Ri-inxhinierim dhe shtim funksionalitetesh/shërbimesh në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re”.

Nga sa më sipër rezulton se, në përgjithësi të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar në masën e planifikuar në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2016-2018. Shpenzimet dhe investimet më të rëndësishme dhe të domosdoshme për Agjencinë e Prokurimit Publik janë realizuar me efikasitet, duke bërë që puna të vijojë me efektshmëri dhe duke plotësuar nevojat e punonjësve për një mjedis të përshtatshëm pune.

9. PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2016

Duke pasur parasysh progresin dhe objektivat e realizuara gjatë vitit 2016, të shpjeguara në këtë analizë dhe në kuadër të detyrave që i ngarkohen me ligj si edhe angazhimeve të ndërmarra në fushën e prokurimit publik këto janë prioritetet kryesore të veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2017:

1. Përafrimi i mëtëjshëm i legjislacionit të prokurimit publik me Direktivat e Bashkimit European në këtë fushë, sidomos sa i takon riorganizimit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe garantimit të pavarësisë së tij.
2. Marrja e masave të nevojshme për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga institucionet ndërkombëtare në raportet e tyre.
3. Implementimi me sukses i funksionaliteteve të reja të Sistemit të Prokurimit Elektronik.
4. Minimizimi i rasteve të përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.
5. Rritja e numrit të monitorimeve të procedurave të prokurimit, me qëllim monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit të prokurimit dhe udhëzimin e autoriteteve kontraktore për përmirësimin e veprimtarisë së tyre në këtë drejtim, në të ardhmen;
6. Trajnimi i zyrtarëve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, pranë autoriteteve kontraktore, me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative, për rritjen e performancës së AK në këtë drejtim;
7. Stimulimin e përdorimit të Marrëveshjes Kuadër, sidomos nga Organi Qendror Blerës, si një mjet që siguron konkurrencën dhe transparencën në kryerjen e procedurave të prokurimit, edhe në rastet e situatave të paparashikuara. Përdorimi i këtij mjeti, do të ndikonte drejtëpërsëdrejti edhe në uljen e rasteve të përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.